

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7686 E hënë 22 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Janë rreth katër mijë e dyqind pika të regjistruara bastesh tek ne. Punësojnë rreth 10 mijë veta. 7200 të punësuar të regjistruar dhe pjesa tjetër, familjet...

Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI

4200 qepenat e fatit



Opinion

Ditës

Gjatë kohës kur po vazhdonin polemikat për vrasjen e gazetarit Khashoggi, sikur për ta ngritur për një nivel më lart konspiracionin, gati krejt pa zhurme...

Vijon në faqen 21

Nga BERAT BUZHALA

Pse e sharruan sauditët gazetarin Kashoggi në Turqi?



Arrestohet "bosi" i Shijakut, Astrit Avdyli

## Dështojnë dy operacionet, "shpëtojnë" Lul Berisha e Balili

"Blindohet" Durrësi dhe Saranda. Dyshimi, lëvizjet e forcave speciale u dekonspiruan

Policia e Shtetit është ngritur në këmbë duke kryer një aksion antidrogë në të gjithë vendin. Shumë qytete nga veriu në jug janë në alar m pas pranisë së forcave të shumta RENE. "Balkanweb" raportoi dhe se u krye një aksion për kapjen e Lul Berishës, me policinë që ka bastisur në shtëpinë e tij, edhe pse ky i fundit nuk është ...

Në faqen 9

## ARRESTOHEN ISH-DREJTORI I BURGJEVE, ARBEN ÇUKO DHE ARBEN NDOKA

# KORRUPSION E FALSIFIKIM, NE PRANGA 2 ISH-DEPUTETE TE PS

Dyshimi, Çuko mori lekë nga një i dënuar për transferim. Edi Rama: Keqardhje.

Policia: Ish-deputeti Ndoka ndërhyri për tjetërsimin e pronave në Lezhë



(Në foto) Ish-deputeti Arben Ndoka. Ish-rrejtori i Pergjithshëm i Burgjeve, Arben Çuko

Në faqen 2-3

INTERVISTA

**Ervin Salianji:**  
Opozita, në presion qytetar për të rrezuar qeverinë

Në faqen 4-5

"LIFE PAGES"

**Mjeku popullor:**  
Ja si të luftoni ankthin e stresin me bimën e veçantë

Suplement

KREU I PDIU

**Fondet sekrete greke për median, Idrizi: Metoda të luftës së ftohtë**

Në faqen 5

FUTBOLL

**Goli i Ikardit në minutën e '92 i jep fitoren Interit në derbi**

Në faqen 22

MUNDËSI PËR STUDENTËT



"Luarasi", 5 ditë program me ekspertë nga shtete të ndryshme të botës

Në faqen 8

Instituti i Sigurimeve Shoqërore publikon kushtet dhe mënyrat e pagesës

## Sigurimi vullnetar, si të përfitoni pension

Kontributi minimal, 5184 në muaj. Zbritje, nëse parapaguani për një vit

NGA VOLTIZA DURO

Të gjithë ata që nuk i kanë plotësuar vitet e punës me kontribute për të përfituar pension, tashmë kanë një zgjidhje. Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën thirrje jo vetëm për të moshuarit që nuk i kanë plotësuar



vitet e punës, por edhe për ata që dëshirojnë të marrin një pension të plotë që të bëjnë sigurim vullnetar. "Qytetarë! Instituti i Sigurimeve Shoqërore ju ofron sigurimin shoqëror vullnetar, si një mundësi më shumë për të përfituar pension pleqërie, invaliditeti ...

Në faqen 7

## LUFTA KUNDER KRIMIT OPERACIONI

46-vjeçari dorëzoi mandatin në 2015-ën, pasi u prek nga "dekriminalizimi"

# Pranga ish-deputetit të PS, Arben Ndoka ndikoi për tjetërsimin e pronave

"Falsifikim dokumentesh" dhe "Shpërdorim i tokës"

Arrestohet ish-deputeti i Partisë Socialiste, Arben Ndoka. Ai është prangosur nga RENEA pasditen e djeshme së bashku me dy persona të tjerë, ndërsa sipas policisë Ndoka ka ndikuar në tjetërsimin e pronave në Lezhë. Por, si është zbuluar Ndoka? Gjatë përgjimeve të një grupi kriminal ka dalë emri i Ndokës, i cili më pas është vendosur në përgjim, duke zbuluar aferën dhe dërguar në arrestimin e tij nga policia pas urdhrat të prokurorisë. Ndoka ka ndikuar për tjetërsimin e një prone shtetërore të "Rana e Hedhun" të të afërmit të tij. Ish-deputeti ishte në përgjim prej disa muajsh. Në shtator të vitit 2015, Ndoka dorëzoi mandatin e deputetit, pasi u prek nga ligji i dekriminalizimit, pasi kishte një dënim në Itali.

### NJOFTIMI I PLOTË I POLITICISË SË SHTETIT:

Policia e Shtetit ka ekzekutuar urdhrin e arrestit për shtetasin Arben Ndoka, 46 vjeç, nga Lezha, për të cilin Gjykata e Krimeve të Rënda ka caktuar masën "Arrest në burg". Ai dyshohet për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve", "Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve", "Shpërdorimi i tokës", në kuadër të një grupi kriminal, të përfshirë në tjetërsim tokash. Hetimi disamujor ka mbledhur prova se ky grup kriminal dyshohet si i implikuar në abuzimet me troje shtetërore në zonën e Lezhës dhe Kurbin, përmes falsifikimit të dokumenteve e vulave etj. Në mars 2018, Policia e Lezhës hetoi një grup kriminal që dyshohej se ishte lidhur me abuzimet toka e troje në zonën e Shëngjinit dhe ndaloi 12 persona, mes tyre edhe kryetari i Bashkisë Lezhë, ndërsa 11 u shpallën në kërkim. Ata në bashkëpunim me njëritjetrin akuzohen se kanë falsifikuar, tjetërsuar dhe përvetësuar 234,548 m<sup>2</sup> tokë shtetërore ranishte në zonën bregdetare Shëngjin, Lezhë. Me gjithë



I arrestuari, ish-deputeti i Ps-së, Arben Ndoka

### AKUZAT NDAJ ARBEN NDOKES

Ai dyshohet për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve", "Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve", "Shpërdorimi i tokës", në kuadër të një grupi kriminal, të përfshirë në tjetërsim tokash.

provat e forta të paraqitura nga policia dhe prokuroria, Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë dhe Gjykata e Apelit Shkodër ndryshuan masat për një numër të konsiderueshëm shtetasish, mes tyre edhe kryetari i Bashkisë Lezhë, si

### KUSH ESHTË

Arben Ndoka dhe dorëheqjen nga mandati i deputetit, pasi akuzohej se kishte fshehur dënimin për favorizim prostitucioni dhe shfrytëzim personi. Kohët e fundit, PD e akuzonte se po merrte me fushatën e PS-së në Dibër. Deri më sot ai ishte i angazhuar me PS-në në Lezhë.



Ish-drejtori i Burgjeve, Arben Çuko

### OPERACIONI

"Tokat", arrestohet edhe vëllai i Arben Ndokës

Policia e Shtetit mësohet se përveç ish-deputetit socialist të Lezhës, Arben Ndoka, ka vënë në pranga edhe vëllain e tij. Ai quhet Xhevahir Ndoka, i cili është pjesë e së njëjtës çështje për të cilën është ndaluar Arben Ndoka. Arrestimi i tij është bërë në kryeqytet nga forcat RENEA. Arben Ndoka është arrestuar, pasi mbiti të rëndon akuzat e tjetërsimit të pronave në Lezhë. Pak kohë më parë, njërit prej vëllezërve Ndoka, Aleksandrit iu bë një atentat në hyrje të shtëpisë që i mori jetën. Autorët nuk janë zbuluar ende. Për 46-vjeçarin Arben Ndoka, Gjykata e Krimeve të Rënda ka caktuar masën "Arrest në burg". Ai akuzohet për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve", "Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve", "Shpërdorimi i tokës", në kuadër të një grupi kriminal, të përfshirë në tjetërsim tokash. Hetimi disamujor ka mbledhur prova se ky grup kriminal dyshohet si i implikuar në abuzimet me troje shtetërore në zonën e Lezhës dhe Kurbin, përmes falsifikimit të dokumenteve e vulave etj.

### 3 të arrestuar, 2 në kërkim, u përvetësuan 6.8 hektarë tokë

## Abuzimet me pronat, ish-punonjës të Hipotekës dhe përfitues, në pranga



tjerë me masë sigurie "Arrest në shtëpi". Si rezultat i këtij operacioni janë proceduar penalisht 11 shtetas (ish-punonjës pranë

Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Kurbin dhe qytetarë përfitues toke), të cilët, në bash-

këpunim me njëritjetrin duke abuzuar me detyrën kanë falsifikuar, tjetërsuar dhe përvetësuar 68120 m<sup>2</sup> tokë në Kurbin, pasi duke qenë punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Kurbin kanë shpërdoruar detyrën nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve, nëpërmjet ndryshimit të zërit kadastral kanë dhe pajisur me AMTP persona të ndryshëm dhe i kanë regjistruar pranë Z.V.R.P.P. Kurbin.





Arben Çuko u shkarkua pak ditë më parë, u zëvendësua nga Stefan Çipa

# Pranga ish-drejtorit të Burgjeve, dyshimet: Mori para nga i dënuari

## Akuza për ish-deputetin e PS: Korrupsion pasiv

Ish-drejtori i Burgjeve, Arben Çuko u arrestua dje pasi dyshohet se është i përfshirë në korrupsion pasiv, gjatë kohës që ushtronte detyrën e drejtorit të Burgjeve. Urdhër-arrestit u ekzekutua dje pasdite dhe ish-deputeti i PS-së, Arben Çuko u ndalua në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Tiranës. Rreth dy muaj më parë Çuko u shkarkua nga posti i tij dhe vendin ia zuri Stefan Çipa. Motivacioni i këtij ndryshimi ishte rritja e sigurisë në burgje. Sipas njoftimit zyrtar të shpërndarë nga Ministria e Drejtësisë, në atë kohë thuhej se, "ky ndryshim bëhet për të përmirësuar punën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, veçanërisht në drejtim të rritjes së sigurisë së brendshme dhe kontrollit si dhe rritjes së efikasitetit të luftës kundër korrupsionit në sistemin e burgjeve". Burimet për "BW" bëjnë të ditur se Arben Çuko mori një shumë parash dhe një makinë në këmbim të transferimit të Olsi Karagojzit. Por transferimi ka dështuar dhe korrupsioni i ish-drejtorit ka dalë në dritë. Pas arrestimit të ish drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Arben Çuko, ka reaguar kryeministri i vendit, Edi Rama. Në një postim në "Twitter" ai është shprehur i keqardhur për Çukon, por shkruan se nuk ka 2 qëndrime në raport me ligjin.

### KUSH ËSHTË OLSI KARAGOJZI

Olsi Karagojzi qëllonte biznesmenët, paguhej nga rivalët. Shënjestra e tij kanë qenë kryesisht biznesmenët dhe sipërmarrësit e mesëm. Ka kryer pesë atentate ndaj tyre, por asnjërin nuk e ka vrarë. Sulmet me armë dyshohet se janë paguar nga kundërshtarët e të dëmtuarve, ndërsa janë vënë në zbatim nga i akuzuari për pesë tentativa vrasjeje dhe një grabitje. Olsi Albert Karagojzi, 36 vjeç, lindur e banues në Laprakë, i njohur edhe me nofkën "Olsi i Qamiles". I dyshuari për serialin e ngjarjeve është vënë në pranga nga policia e Tiranës pas një hetimi disamujor më 12 janar 2013. Ndaj tij ishin lëshuar disa urdhra kërkimi nga policia dhe nga gjykata, për shkak të krimeve në të cilat ishte implikuar.



### "Janë të lirë përbindëshat e krimit"

## Batuta e Ylli Manjanit: S'jua lajnë dot zhulin 2 "peshqit e ngordhur"

Pas arrestimit të dy ish-deputetëve socialistë, Arben Çuko dhe Arben Ndoka, ka ardhur dhe reagimi i ish-ministrit të Drejtësisë, Ylli Manjani. Ai i ka cilësuar dy ish-socialistët si "peshq të ngordhur". Manjani në një status në "Facebook" shkruan se ndaj qeverisë se, "nuk jua lan dot zhulin burgosja as Arben Ndokës e as Arben Çukos, të cilët duhet të ishin arrestuar kohë më parë, meqë ra fjalla".

### POSTIMI I MANJANIT

"Me arrestime 'peshqish të ngordhur' nuk mund të justifikohen mosarrestimet e përbindëshave të krimit!

Nuk jua lan dot zhulin burgosja as Arben Ndokës



e as Arben Çukos, të cilët duhet të ishin arrestuar kohë më parë, meqë ra fjalla. Trafikantë droge, bashkëpunëtorët e tyre në shtet, penguesit e drejtësisë, zhdukësit e provave e dëshmitarëve, fabrikuesit shtetërorë të provave, konce-

sionarë që pastrojnë paratë e qeveritarëve, grabitës të pronës e pasurive publike, marrësit e borxhit publik, pa harruar aspak dhunuesit e Kushtetutës, që duan të falin hapësirën detare Greqisë për 1 milion euro etj. si këto janë ende të lirë...

Jo vetëm me dy, por me një gamet standardesh është sjellja zyrtare e Rilindasve! Kur flasin edhe për drejtësi, të hapin barkun! Ndërkohë, ata vetë e kanë shkelur ligjin me të dyja këmbët. E kanë shkel shumë më rëndë se ata që arrestuan sot për t'i hedhur hi syve publikut. As skandalët që priten të bëhen publike nuk mund t'i sfumojnë këto arrestime...

Zullumi është trashur shumë".

### REAGIMI I EDI RAMES

"Keqardhje për A.Çukon, por për ne s'ka dy qëndrime në raport me ligjin, ka vetëm një; s'ka dy qasje në raport me drejtësinë, ka vetëm një; s'ka dy fytyra në raport me qytetarët, ka vetëm një! Ne s'jemi e kurrë s'do jemi njësoj si të tjerët. Ne gjithnjë kemi vetëm një krah: Drejtësinë!", shkroi kryeministri në "Twitter".

### ISH-KREU I PD

## Berisha: Keqardhja e Ramës për Arben Çukon, e ndjerë

Ish-kryeministri Sali Berisha ka reaguar pas arrestimit të ish-deputetit socialist, Arben Çuko. Ai gjithashtu ka komentuar edhe reagimin e menjëhershëm të Ramës pas vënies në pranga të ish-drejtorit të Burgjeve. Në një status në "Facebook", deputeti i Partisë Demokratike thotë se sa do të ketë vjedhur Çuko, është vite dritë larg "Kallam Dështakut".

### STATUSI I PLOTË

"Kallam Dështaku e ka të ndjerë keqardhjen për Çukon!

Të dashur miq, me vrap pas arrestimit të Arben Çukos, Kallam Dështaku reagoi duke thënë: Keqardhje për Arben Çukon.

Unë mendoj se keqardhja e tij për hajdutin Arben Çuko, është e ndjerë! Sepse sado që të ketë vjedhur Çuko është vite dritë larg në hajni me ato që ka vjedhur Kallam Dështaku, Zho Zho apo ndonjë ministër tjetër. Krahasuar me këta, Çuko del hajdut thërrimesh! Sb".



## STRATEGJIA E OPOZITËS

### INTERVISTA

Deputeti i PD: Gjithçka mund të ndodhë, në një datë mund të bëhen dy palë zgjedhje

Valentina Madani

Ervin Salianji, një ndër deputetët më aktivë të opozitës, ndodhet në rreshtin e parë të saj sa herë që bëhet fjalë për përballje politike, ndaj dhe është më i sulmuari nga mazhoranca e majtë. Por, Salianji tregon për "Gazeta Shqiptare" se do të vazhdojë të denoncojë me fakte dhe prova konkrete për çdo rast korrupsioni qeveritar. Ai thotë se asgjë nuk e shantazhon e as nuk e blen dot. I pafrikësuar në misionin për të përfaqësuar, sipas Salianjit qindra mijëra qytetarë mbështesin sot PD-në.

**Z.Salianji, kohët e fundit gjithnjë e më shpesh ju shohim me dosje në duar, çfarë përmbajnë ato...?**

Kanë qenë dosje për raste të denoncuar nga opozita, dosje të plota për përfshirjen e shtetit për të sajuar, prishur apo fabrikuar prova dhe dëshmitarë për të shpëtuar ministrin e Brendshëm. Kanë qenë dokumente shkresore të institucioneve apo video ku faktohej qartë se si shteti sot përdorte metodat e "Sigurimit" vetëm për të përfshirë opozitën. Dosjet e tjera që shihni janë fakte për denoncimet e qytetarëve apo institucioneve që vijnë të Partia Demokratike, si institucioni më i besueshëm për shqiptarët sot. E patë se si me dokumentet e Ministrisë së Brendshme u faktua se nga sistemi TIMS Balla udhëtonte 57 herë me trafikant, që ka përfituar miliona euro tendera dhe pasuri publike në zonën e tij. Të tilla fakte dhe prova kemi publikuar dhe do të publikojmë sapo të bëjmë verifikimet e nevojshme për çdo rast.

**Pse kaq shumë kallëzime penale mes jush dhe Ballës, PD-së dhe PS-së?**

Ne kemi bërë kallëzime penale për shpërdorimet e fondeve publike, për korrupsion dhe lidhjet e qeverisë dhe deputetëve me krimin e organizuar dhe favorizimet që i bëhen kriminit. Deputetët e opozitës, përfshirë mua, janë të kallëzuar nga një i dënuar për trafik droge, Agron Xhafaj. Paditë e tjera të PS dhe Rama-Balla, dyshja qeverisëse i bënë për të "blerë kohë" duke iu thënë shqiptarëve që jemi të gjithë njëjloj, që të gjithë shkojmë në

# Salianji: Opozita, nën presionin e qytetarëve për të rrëzuar Ramën

## "Në PD, brenda një ditë më shumë se 30 denoncime"



Deputeti i PD-së, Ervin Salianji

prokurori dhe gjykata, por askush nuk e harron që opozita shkon sepse denoncon krimin, ndërsa qeveria për miliona euro abuzime, për favorizim të kriminit etj. Ne nuk jemi njëjloj. Ata janë përfittues, shkatërrues dhe plaçkitës të Shqipërisë, ndërsa ne denoncojmë të zullumeve të tyre dhe shpresa e vetme që kanë shqiptarët.

**Taulant Balla përmes disa fotove ju akuzon se kemi lidhje me persona me precedentë penalë...**

Budallallëq, unë nuk jam në pushtet dhe nuk kam asnjë mundësi për të favorizuar askënd, po ashtu nuk kam mundësi të verifikoj askënd për aktivitetin e tyre. PS dhe qeveria kanë të gjitha institucionet për të dërguar para përgjegjësisë penale cilindo që shkel ligjin. Unë këtë do të beja. Nuk ka askush asnjë mundësi për të përfittuar apo për të qenë mbi ligjin.

**Ju jeni përfshirë në çështjen "Babale", duke dëshmuar edhe në prokurori, por a besoni se do të mund të vërtetoni akuzat tuaja, ndërkohë që PD vazhdon të akuzojë prokurorinë si vegël të qeverisë?**

Ne i kemi faktuar akuzat dhe çdo qytetar e

"Mendoj që opozita i ka bindur aq shumë qytetarët, sa tani janë vetë ata që po i bëjnë presion opozitës për ta rrëzuar sa më parë një qeveri që nuk ka interes për ta, por për ta privatizuar dhe shpërdoruar çdo aset të Shqipërisë", deklaroi deputeti i PD-së.

ka parë me zë, me figurë dhe me shkresa se si është përfshirë qeveria për të fabrikuar një aktor. Qytetarët e panë se si shkoi në burg Agron Xhafaj, pasi i fshihej drejtësisë prej vitesh. Sot prokuroria e pavarur do të duhej të bënte drejtësi për Ramën, Xhafajn, Velinun për shpërdorim detyre, pengim të drejtësisë etj. Dita për të dhënë llogari edhe ata para drejtësisë do të jetë e afërt.

**Ju jeni deputeti më i sulmuar nga mazhoranca, për cilat arsye?**

Besoj se arsyt janë të qarta për çdo qytetar. Unë kam qenë dhe do të jem ak-

#### DENONCIMET

"Në PD çdo ditë vijnë minimalisht 30 qytetarë në ditë për denoncime, për të kërkuar ndihmë për çështje të caktuara apo për të kërkuar që deputetët e PD-së të ngrënë zërin për çështje që shqetësojnë qytetarët. Ne mbledhim çdo fakt apo çdo të dhënë që na vjen, e verifikojmë me burimet tona në terren, e ballafaqojmë me dokumente dhe më pas e publikojmë", tha sekretari për aksionin qytetar në PD.

30 qytetarë në ditë për denoncime, për të kërkuar ndihmë për çështje të caktuara apo për të kërkuar që deputetët e PD-së të ngrënë zërin për çështje që shqetësojnë qytetarët. Ne mbledhim çdo fakt apo çdo të dhënë që na vjen, e verifikojmë me burimet tona në terren, e ballafaqojmë me dokumente dhe më pas e publikojmë. Shpeshherë, ne i orientojmë qytetarët edhe tek media investigative, ashtu siç dhe shpeshherë zyrtarë të ndershëm të policisë, ministrive, administratës publike na sjellin fakte dhe shkresa konkrete, siç ka ndodhur psh., me TIMS-in e Ballës.

**Çfarë denoncimesh vijnë kryesisht në PD?**

Çdo denoncim që vjen dhe ka vlerë për publikun ne e kemi bërë publike. Vijnë shqetësime për çdo sektor të qeverisjes, por edhe denoncime konkrete për persona konkretë. Shumë denoncime janë për lidhjet e qeverisë me krimin, për papunësinë, për rritjen e çmimeve, për rryshfetet që duhet të paguash për t'u përfshirë në administratë, për mungesën e ilaçeve dhe shërbimeve në spitale, për mungesë infrastrukture etj., etj.

**Si koordinator i PD dhe drejtues i Departamentit për të Drejtat e Njeriut, kenë qenë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët dhe problematikat e tyre. A po i bind dot PD-ja qytetarët që të ngrihen kundër Edi Ramës për ta rrëzuar atë?**

Unë mendoj që opozita i ka bindur aq shumë qytetarët, sa tani janë vetë qytetarët që po i bëjnë presion opozitës për ta rrëzuar sa më parë një qeveri, që nuk ka interes për ta, por për ta privatizuar dhe shpërdoruar çdo aset të Shqipërisë.

**Ju drejtoni grupin e punës për dekriminalizimin e plotë përmes**



Një nga protestat e opozitës në Kuvend

"Ne kërkojmë që të shtojmë si subjekte të kontrollit të pasurisë, integritetit apo lidhjeve me krimin të çdo politikani me të njëjtat kritere dhe standard si në rastin e gjyqtarëve dhe prokurorëve".

**vetingut të politikanëve të lidhur me krimin. Çfarë po bëhet konkretisht në këtë drejtim?**

Ne kemi depozituar në Kuvend projektligjin dhe siç jeni në dijeni, Rama po përpqet ta shtyjë pafundësisht nismën për ndryshimet kushtetuese, duke bërë dëgjesa pa sens, apo duke e dërguar draftin në Komisionin e Venecias, ndërkohë që ky draft e ka marrë opinionin pozitiv të Komisionit të Venecias në rastin e ndryshimeve kushtetuese për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ne kërkojmë që të shtojmë si subjekte të kontrollit të pasurisë, integritetit apo lidhjeve me krimin të çdo politikani me të njëjtat kritere dhe standard si në rastin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Është





"Greqia do zgjerojë ujërat territoriale". Paloka, Bushati: E falënderove Kotzias?

# Fondet "e zeza" greke, Idrizi: Metoda të luftës së ftohtë

"Po manipulojnë shqiptarët për çështjen çame"

Valentina Madani

Kreu i PDIU, Shpëtim Idrizi shprehu dje shqetësimin se përmes fondeve sekrete të Ministrisë së Jashtme greke për mediat shqiptare po përdorshin metoda të luftës së ftohtë për të manipuluar opinionin publik shqiptar në lidhje me çështjen çame. I ftuar në "News 24", z.Idrizi i bëri sërish thirrje Presidentit të Republikës dhe prokurorisë të mbledhin Këshillin e Sigurisë Kombëtare për të hetuar mbi këtë çështje, të cilën ai e cilëson si tradhti kombëtare. "Do doja të theksoja faktin që ajo që ne kishim paralajmëruar doli e vërtetë. Kjo rrodhi nga shtyp grek që nga fondet sekrete të Ministrisë së Jashtme janë dhënë në portale dhe mediat shqiptare për të manipuluar opinionin publik shqiptar në lidhje me çështjen çame. Ne kemi investim direkt të Prokurorisë së Athinës për nxjerrje të sekretit shtetëror, por jo për fondet. Kjo është e rëndë, sepse cenon integritetin shqiptar, duhen hetime direkt nga Shqipëria. Një pjesë e mediave dhe analistëve janë përdorur për influencën greke në Shqipëri. Gjest i rëndë, delikat për marrëdhënien mes dy vendeve. I kemi bërë thirrje presidentit të mbledhë organet ligjzbatuese të Shqipërisë, SHIK-un, prokurorinë, Policinë e Shtetit. Të dalin në dritë cilat janë ato portale e gazetarë, e mbi të gjitha qëllimi për të cilin e kanë bërë", u shpreh z.Idrizi. Pyetjes se sa serioz është impakti dhe sa mund të ketë ndikuar një sasi e tillë parash në Shqipëri, Idrizi iu përgjigj: "Nga të dhënat, vetëm në tetor janë dhënë mbi 1 mln euro, shumë goxha e madhe, imagjinojeni në vite. Asnjë në Shqipëri të mos bëjë sikur nuk e kupton, se e dimë që një pjesë e mediave mendonte të stigmatizonte shqiptarët e Çamërisë. Ne jemi në disa momente me Greqinë: shtet në luftë me Greqinë, s'është hequr ligji i luftës. Kam folur këtu edhe për çështjen e toponimeve. Kemi bërë betejë të madhe për censusin. Kemi folur për marrëveshjen e ujërave, ndërkohë që ministri ynë i Jashtëm heshtte. Sot presidenti deklarohet se nuk do bëhet kjo marrëveshje pa u bërë funksionale Gjykata Kushtetuese. Kjo quhet në kufijtë e tradhtisë". Kreu i



Kreu i PDIU, Shpëtim Idrizi

**SHPËTIM IDRIZI**

Kreu i PDIU-së dhe alarmin se marrëveshja Shqipëri-Greqi po prek sovranitetin e vendit. "Kjo është si tip luftë e ftohtë, por nuk ndodh në asnjë vend që vendet i përgjigjen një-tjetrit me këto metoda. Jemi në një vend në BE që është kandidat për BE", tha kreu i PDIU.

shumë e thjeshtë, kontroll i plotë për çdo politikan dhe shpejtësi për të çuar më pas para drejtësisë, SPAK-ut dhe BKH cilindo që ka probleme me pasurinë apo favorizimin e krimin.

**Para disa kohësh ju keni përmendur një "listë të zezë" me 100 emra, të cilët preken nga vetingu i propozuar nga PD. Për kë bëhet fjalë konkretisht?**

Ne kemi denoncuar çdo ditë lidhjet e qeverisë dhe deputetëve të PS me krimin dhe nuk ka pasur asnjë reagim. Ajo që kam thënë ka qenë që kjo nismë shkoi vetëm në përfitim të qytetarëve. Nga kjo nismë preken vetëm 100 politikanë dhe për këtë arsye nuk ka pse qytetarët të mbeten peng i frikës së Ramës për t'u kontrolluar ai vetë së pari dhe më pas çdo ministër, deputet apo kryetar bashkie.

**Çfarë ndodhë nëse mazhoranca do të refuzojë vetingun e politikaneve?**

Qytetarët dhe shumica dërrmuese e qytetarëve duan pastrimin e politikës nga politikanët e korruptuar dhe të lidhur me krimin. Kjo nismë mund të vonohet ashtu siç ndodhi me dekriminalizimin, por do të kalojë në Kuvend si vullnet i shumicës së shqiptarëve.

**Ku konsiston aksioni opozitar dhe sa kohë do t'i duhet opozitës që të lar-**

**gojë nga pushteti qeverinë, sipas saj të lidhur me krimin?**

Ne jemi çdo ditë në aksion, PD po përfundon riorganizimin në bazë dhe zgjedhjen e strukturave të reja dhe paralelisht po merr mendimin e qytetarëve dhe po përgatitet për vendimin që do të marrë për çdo aksion dhe përballje.

**A i mbështesni zërat brenda së djathtës për djegien e mandateve, apo revoltë popullore kundër Edi Ramës?**

Mbështes çdo që që kërkon realisht rrëzimin e Ramës. Çdo opion duhet dhe do të merret parasysh.

**Nëse opozita s'do ketë garanci për votën e lirë, a do t'i bojkotojë zgjedhjet lokale?**

PD-ja ka paraqitur platformën e saj të plotë për çlirimin e qeverisjes nga krimi dhe reformën e plotë elektorale se si mund të garantohet vota e lirë. Gjithçka do të varet nga pranimi i propozimeve tona. Ne synojmë standardet për zgjedhje të lira dhe të ndershme, pa ndikimin e krimin, pa shitblerje të votës, pa përdorimin e pushtetit për të intimiduar votuesit, pa kriminelë në listat e deputeteve apo kryebashkiakëve. Nëse realizohen këto, gjithçka tjetër mund të ndodhë në çdo moment, zgjedhjet mund të jenë edhe bashkë me lokalet nëse arrihet të vendosen standardet e kërkuara.

PDIU-së dhe alarmin se marrëveshja Shqipëri-Greqi po prek sovranitetin e vendit. "Kjo është si tip luftë e ftohtë, por nuk ndodh në asnjë vend që vendet i përgjigjen një-tjetrit me këto metoda. Jemi në një vend që është kandidat për në BE. Ne si PDIU do i drejtohem prokurorisë dhe presidentit të thërrasin Këshillin e Sigurisë Kombëtare", tha Idrizi.

**DEKLARATA**

Pas deklaratës se Kotzias gjatë ceremonisë së dorëzimit të detyrës se Greqia është gati të zgjerojë ujërat e saj territoriale në krahun perëndimor, nga 6 në 12 milje detare, vjen një reagim nga kampi i demokratëve. Përmes një postimi në "Facebook", nënkryetari i PD-së Edi Pal-

oka pohoi se Kotzias u mburr me këtë deklaratë. Ndërkohë, ai ka bërë edhe një pyetje publike nëse ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati e falënderoi Kotzias për këtë fakt. "Kotzias 'mburret' në ceremoninë e largimit si ministër i Jashtëm se ka zgjeruar territorin e Greqisë nga 6 në 12 milje detare në kufirin me Shqipërinë... Për këtë e falënderoi Bushati?", shkruan z.Paloka. Para se t'i dorëzonte zyrën kryeministrit Cipras, i cili do të mbajë edhe portofolin e ministrit të Jashtëm, shefi i dorëhequr i diplomacisë greke Nikos Kotzias, renditi si arritje historike për vendin zgjerimin e sovranitetit kombëtar nga 6 në 12 milje, duke iu referuar negociat-

ave me Shqipërinë dhe Italinë për çështjen e kufirit detar. "Jemi në një fazë përfundimtare të negociatave me Shqipërinë dhe Italinë. Janë gati dy dekrete presidenciale dhe sipas udhëzimeve që kam, vendi ynë zgjeron zonën detare nga ishulli Othonoi dhe ishujt Diapontia deri në Antikythera. Janë tri hapa që janë ezuruar, mbyllja e gjireve, krijimi i vijave bazë dhe hapi i fundit zgjerimi nga 6 në 12 milje. Kjo na lehtëson diskutimet për zonat detare me Shqipërinë dhe Italinë. Pra, zgjerimi sovranitetin tonë në 12 milje, që do të thotë se rriten edhe përgjegjësitë e kryeministrit dhe qeverisë", deklaroi z.Kotzias.

## "Qeveria dhe opozita të punojnë së bashku"

### Ambasadorja franceze: Koha nuk pret, s'ka negociata pa kryer detyrat

Francia përmes ambasadores së saj në Tiranë paralajmëron se nuk do të ketë hapje negociatash për Shqipërinë vitin e ardhshëm, nëse nuk zbatohen të gjitha detyrat e lëna nga bashkimi evropian në 26 qershor. Nga Korça, ku mori pjesë në ceremoninë për 20-vjetorin e aleancës Francë-Shqipëri, ambasadorja Christine Vasak i bëri apel qeverisë e opozitës të punojnë së bashku, pasi nuk ka mbetur dhe shumë kohë. "Po afrohet muaji nëntor dhe koha ikën shpejt. Konkuzionet e Këshillit të 26

qershorit duhen marrë shumë seriozisht nga autoritetet shqiptare, jo vetëm me fjalë, por edhe në praktikë. Mendoj se qeveria dhe opozita e dinë këtë gjë. Konkuzionet e Këshillit duhet të përkthehen në fakte dhe nuk do të ketë hapje të negociatave për anëtarësim, nëse nuk merrni seriozisht në praktikë këto konkluzione për të gjitha çështjet", deklaroi zj.Vasak. Një nga çështjet e nënvizuara nga Këshilli ka qenë edhe reforma zgjedhore për të cilën diplomatja franceze është shprehur optimiste se do të përfundojë në kohë. Përsa i për-

ket reformës zgjedhore, ajo po ndjek rrjedhën e vet dhe jam e bindur se dy bashkëkryetarët po bëjnë çdo gjë që është e mundur me frymën e duhur për të çuar para reformën zgjedhore. Në qershor Franca ishte një ndër 3 vendet anëtare të Bashkimit Evropian që këmbëngulën për shtyrjen e negociatave për vitin e ardhshëm dhe në 2019-ën beteja më e vështirë për Shqipërinë do të jetë të bindë Parisin zyrtar se meriton çeljen e bisedimeve për anëtarësim në BE.

## PROJEKTI PËRPLASJA

Valentina Madani

Demokratët akuzojnë kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj se në mënyrë abuzive, në bashkëpunim me kryeministrin Rama ka ndryshuar planin rregullues të 2013-ës për të lejuar ndërtimin e kullave brenda hapësirës së parkut të liqenit. Sipas kreut të departamentit të mjedisit, Jamarber Malltezi, Rama dhe Veliaj janë peng të interesave të mafies dhe se plani rregullues i bashkisë mbahet i fshehtë dhe se hyrja e parkut të liqenit po kthehet në beton masiv. "Plani mafioz Rama-Veliaj ndryshoi planin e vitit 2013, i cili ndalonte ndërtimet në çdo park apo lulishte të qytetit. Në kapitullin 7.4 të planit të 2013-ës duken qartë kufizimet dhe ndalimet e ndërtimeve në parqet dhe lulishtet e Tiranës. Është e papranueshme që plani rregullues i Tiranës mbahet i fshehtë. Plani i Edi Ramës dhe Erion Veliaj është që ta mbajnë në heshtje deri në zgjedhjet e ardhshme lokale dhe qytetarët të mos kenë informacion për këtë aferë të rëndë korruptive, për këtë krim mjedisor, që shkatërron hyrjen e parkut të liqenit dhe shëndetin e qytetit", u shpreh z.Malltezi. Sipas tij, në sipërfaqen e Gardës së Republikës do të ketë ndërtime, gjë e cila i ka detyruar të mbajnë sekret planin rregullues të Tiranës deri pas zgjedhjeve lokale. "Të dy heshtën dhe akoma nuk kanë dhënë llogari për vendimin e tyre, i cili lejon që kryeqytetit t'i hiqet një pjesë e mushkërisë së tij për t'u zëvendësuar me beton. Këta janë të njëjtët që heshtën, kur ne denoncuan se brenda parkut të liqenit, dy mikeshat e Edi Ramës po ndërtonin vila në kundërshtim me çdo ligj në fuqi. Qytetarët e Tiranës duhet ta dinë se kafshimi i parkut të liqenit për interesat e mafies së ndërtimit, të lidhur me bashkinë dhe me qeverinë është pjesë e planit të ri të Tiranës", deklaroi Jamarber Malltezi.

**REGAGIMI**  
Por, ndryshe nga sa pretendojnë demokratët, kryebashkiaku i Tiranës, Veliaj theksoi se parkut kombëtar do t'i shtohen 2.5 ha nga sipërfaqja e Gardës për ta shndërruar atë në zonë më të aksesueshme nga qytetarët e Tiranës, ndërsa pjesa tjetër i kalon Ministrisë së Ekonomisë. Ai përmendi se shumë hapësira të paaksesueshme në parkun e Liqenit u janë kthyer qytetarëve. "E kuptoj shqetësimin e PD! Të gjitha këto kanë qenë lloqma të prenotuara për kunetër,

"Zona e Gardës u kthehet qytetarëve", Malltezi nxjerr dokumentet: Po betonizohet

# Përplasja për parkun e liqenit, PD: Plan mafioz i qeverisë

Veliaj: Vendimi shton hapësirat e gjelbra

### JAMARBËR MALLTEZI

"Bashkia e Tiranës ka ndryshuar planin e vitit 2013 që ndalonte ndërtime në çdo park dhe lulishte të qytetit. Me planin e ndryshuar, hyrja e parkut të liqenit kthehet në beton masiv. Parku dhe plani rregullues i bashkisë mbahet i fshehtë duke mos e publikuar. Hyrja e parkut të liqenit po betonizohet", - theksoi z.Malltezi.



### ERION VELIAJ

"Me një vendim qeverie, kryeministri Rama dhe ministrat i falën qytetit një hapësirë që ishte një zonë e paaksesueshme nga qytetarët, kryesisht për mjete të ushtrisë dhe Gardës, portani e gjitha do të shkojë në administrim të APR-së", tha kreu i Bashkisë së Tiranës.

për vjehtë. E kuptoj shqetësimin e tyre, duhet të jenë realist të tondritur që kjo hapësirë i shkon qytetit dhe jo kunetërve. Fakti që dalin përditë për këtë hapësirë do të thotë se u ka dhembur shumë që këtë hapësirë do e gëzojnë qytetarët e Tiranës dhe jo ata që, në fakt duhet të kalojnë në veting. Pran-

daj, që gjithë jemi buzagaz kur dëgjojmë për vetingun e Lul Bashës, sepse ne presim vetingun e SPAK dhe BKH, që i shkon edhe vjehtërit, edhe kunatit, gjithë fisit e farës, ku parkohen asetet e vjedhura nga ky vend. Ndërkohë, marrim sot një version komplet të holluar, ku vetingun e bëjnë vetë

politikanët, ku nuk preken vjehtërit e kunetërit dhe ku sigurisht, nuk japin llogari për të gjitha dëmet që i kanë bërë këtij vendi. Por, në kemi nevojë për një veting të vërtetë, kemi nevojë për agjenci të vërteta që i menaxhojnë këto asetet dhe jo për vjehtërit e kunetërit", tha Veliaj.

### SHKURT

## Berisha, akuzua Ballës: I përfshirë në trafikun e prostitucionit

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzon kryetarin e grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla se ka qenë i përfshirë në trafik prostitucionit. Në një postim në rrjetet sociale, Berisha publikon denoncimin e një "qytetari dixhital", por shprehet se edhe burime diplomatike i kanë konfirmuar këtë fakt. Sipas ish-kryeministrit, Balla është ndaluar nga policia e shteteve të huaja për këto akuzat. Berisha thotë se Balla është përfshirë në trafik prostitucionit në vitin 1994, kur ka qenë me studime universitare në Rumani. Berisha publikoi mesazhin e një qytetari të thjeshtë, që shprehet se në kohën kur ka studiuar në Rumani, Balla ka trafikuar vajza moldave, duke iu bërë garancitë përmes ambasadës për në Shqipëri. "Balla akuzohet përsëri se është marrë edhe me trafik prostitucionit! Burime diplomatike kanë informuar në momentin e marrjes së Taulant Begos/ Yaris etj., etj., këshilltar në Kryeministri për marrëdhëniet me trafikantët, se ai është ndaluar nga policia të vendeve të tjera fqinje për trafik të skllërvëve të seksit" - shprehet z.Berisha.

## Forcat Speciale 20 vjeç, Xhaçka: Aset kombëtar, do të modernizohet

Batalioni i Forcave Speciale shqiptare festoi dje 20-vjetorin e krijimit, që u shndërrua në festë, ku morën pjesë edhe familjarët e pjesëtarëve të këtij batalioni. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, premtori mbështetje si në trajtimin e tyre, ashtu edhe në modernizimin e batalionit. "Forcat tona Speciale, kjo forcë e vogël, por me një mision të madh, do të kenë vëmendjen dhe mbështetjen tonë për të marrë vlerësimet e duhura për punën që ata kryejnë. Siguria sot është mbi gjithçka dhe këta djem janë këtu pikërisht si gardianë të lirisë dhe të sigurisë së vendit tonë dhe si të tillë duhet të trajtohen ashtu siç e meritojnë. Gjithashtu, ne do të vijojmë punën që kjo forcë të modernizohet më tej dhe mbetet në lartësinë e detyrës. Jeni vërtet specialë dhe vendi do t'ju jetë përherë mirënjohës për çfarë ju kemi bërë dhe vijoni të bëni", theksoi ministrja Xhaçka, e cila kujtoi edhe dëshmorin e atdheut, kapiten Feti Vogli.

## "Hetim tokave të shpërndara pas vitit 1993"

## Pronësia mbi tokën, Braçe propozon 2 projektligje për problematikën

Kreu i Komisionit parlamentar të Ekonomisë, Erjon Braçe propozon dy projektligje, që sipas tij do të zgjidhin problematikën e pronësisë mbi tokën për të gjithë ata që kanë përfituar me fondin e ish-ndërmarrjeve bujqësore. Sipas tij, dy projektligjet synojnë rregullimin e problematikës së marrjes së pronësisë mbi tokën të familjeve që kanë përfituar nga fondet e ish-ndërmarrjeve bujqësore. "Ligji vendos si afat kohor kur personi është vendosur në territor gushtin e vitit 1991. Ka ndodhur që njerëzit janë zhvendosur para kësaj periudhe, por për shkak të trazirave, pasaportiz-

imi ka ndodhur pas gushtit të 1991-shit", shprehet ai. Prej 1991 e këtej e kanë tokën thjesht në përdorim dhe ligji aktual iu kufizon atyre mundësinë e marrjes së një certifikate pronësie. Në ju njohim të drejtën që të provojnë faktikisht vendosjen në këto terriore para gushtit të 1991, tha Braçe. Ai shprehet për "TCH" se mjaft familje që janë shpërngulur në fillim të viteve 1990 nuk mund të marrin dot hipotekën, pasi nuk kanë qenë të regjistruar si banues të fshatit, ndërkohë që ata faktikisht kanë marrë tokë në dorëzim. Subjektet duhet të provojnë gjithashtu që nuk kanë marrë tokë tjetër në zonën ku banonin

më parë. Po ashtu, Braçe propozon që t'i hiqet heqja e të drejtës për të marrë hipotekës për subjektet që e kanë marrë tokën në përdorim nga ish-ndërmarrjet bujqësore dhe më pas janë shpërngulur nga vendbanimi duke e lënë atë djerrë. "E kanë marrë në përdorim, por që s'e kanë përdorur më. E më pas ata janë larguar. Kjo tokë duhet t'i kthehet shtetit", u shpreh ai. Afati i ri që propozohen për regjistrimin e tokës të përfituar nga ish-ndërmarrjet bujqësore është qershorë vitit të ardhshëm, ndërkohë Braçe shprehet se për tokat e shpërndara pas vitit 1993 duhet një hetim i thellë.



## PENSIONET E PLEQËRISË RRITJA E MASËS

Voltiza Duro

Të gjithë ata që nuk i kanë plotësuar vitet e punës me kontribute për të përfutur pension, tashmë kanë një zgjidhje. Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën thirrje jo vetëm për të moshuarit që nuk i kanë plotësuar vitet e punës, por edhe për ata që dëshirojnë të marrin një pension të plotë që të bëjnë sigurim vullnetar. "Qytetarë! Instituti i Sigurimeve Shoqërore ju ofron sigurimin shoqëror vullnetar, si një mundësi më shumë për të përfutur pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar", - thekson ISSH. Ndërkohë, kjo e fundit bën me dije për të gjithë të interesuarit se pensioni i plotë i pleqërisë përfitohet me 36 vite e 4 muaj punë të siguruar, ndërsa pensioni i pjeshëm kërkon minimalisht 15 vite pune me sigurime. Për të përfutur pension nga shteti shqiptar, emigrantët duhet të paguajnë një pagesë kontributi prej 5184 lekësh në muaj. "Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave, do të ketë zbritje: 6% mbi shumën për një pagesë vjetore, 3% mbi shumën për një pagesë 6 mujore, dhe 1.5% mbi shumën për një pagesë 3-mujore. Ju mund të siguroheni edhe për vitet e kaluara dhe mund të futeni në këtë skemë pa qenë të siguruar më parë. Kontribuoni për të kaluarën dhe të tashmen, t'ju sigurojmë të ardhmen!", - bën thirrje Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Por, nëpërmjet sigurimit vullnetar, mund të përfitojnë jo vetëm emigrantët shqiptarë, por të gjithë qytetarët që jetojnë në Shqipëri e dëshirojnë të kenë një masë pensioni më të lartë se ai që është paracaktuar më parë.

### KRITERET

Në skemën e sigurimit vullnetar përfshihen shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe akoma nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfutim nga skema e sigurimit të detyrues, ata që për një kohë dhe shaka të caktuara nuk mund të sigurohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm si dhe personat që janë të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm dhe kërkojnë që nëpërmjet sigurimit vullnetar të rrisin të ardhurat e tyre. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore, edhe personat që nuk janë pjesëmarrës në skemën e vetëpunësuarve në bujqësi ose në rastet kur individit i interesuar ka lënë shtetësinë shqiptare, mund të bëjë sigurim vullnetar vetëm për periudhën nga

"Kufijtë e pagesës që mund të kryeni dhe tarifat mujore. Si të merrni më shumë të ardhura"

# ISSH: Si të përfitoni pension pleqërie nëpërmjet sigurimit vullnetar

"Cilat janë zbritjet që mund të keni nga parapagimet"

## 6%

### ZBRITJE PARAPAGESË 1 VIT

"Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave do të ketë zbritje 6% mbi shumën për një pagesë vjetore", - bën me dije Instituti i Sigurimeve Shoqërore në faqen e tij zyrtare.



## 3%

### ZBRITJE PARAPAGESË 6 MUAJ

ISSH bën me dije se pensioni i plotë i pleqërisë përfitohet me 36 vite e 4 muaj punë të siguruar. Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave do të ketë zbritje 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore.

1.1.1994 deri në datën që ka lënë shtetësinë shqiptare. "Personi që ka paguar kontribut për sigurim vullnetar, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin nr. 7703, është përfutur, sipas rastit, i: pensionit të plotë të pleqërisë, pensionit të pjeshëm të pleqërisë, pensionit të reduktuar të pleqërisë, pensionit të invaliditetit, pensionit të pjeshëm të invaliditetit", - thekson ISSH. Ndërkohë, në sigurim vullnetar, sipas ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" bën pjesë edhe pensioni familjar. Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga personi i siguruar në shumën dhe afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar. Nëpërmjet sigurimit vullnetar mbulohen katër fusha të kësaj skeme që janë: sigurim vullnetar për vitin korrent, sigurim vullnetar për periudha të kaluara, sigurim vullnetar për më shumë të ardhura si dhe sigurim vullnetar për degët e tjera të sigurimit.

moshën 18 vjeç dhe që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfutim nga skema e sistemit të detyrues si dhe shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha pasuniversitare është me pagesë. Ndërkohë ky sigurim për periudhat e kaluara mund të bëhet edhe nga shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar. Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa. Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar; por në këto pagesa nuk aplikohen zbritjet.

### SIGURIM VULLNETAR PËR PERIUDHA TË KALUARA

Sigurim vullnetar për periudhat e kaluara mund ta paguajnë të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur

Shoqërore bën me dije se masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar për vitin korrent nga personi i interesuar është e barabartë me masën që paguhet për degën e pensioneve, sipas pagës minimale të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa. "Kuota mujore e sigurimit vullnetar për vitin 2017 është 5 184 lekë, që i korrespondon pagës minimale mujore: 24 000 lekë x 21.6%. Për pagesat paradhënie, aplikohen zbritje në varësi të kohës kur kryhet pagesa. Kështu, nëse do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhave, do të ketë zbritje: - 6% mbi shumën për një pagesë vjetore (me kusht që pagesat të realizohen brenda muajit janar), - 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 6-mujore, që do të mbulohej me sigurim vullnetar), - 1.5% mbi shumën për një pagesë 3-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 3-mujore, që do të mbulohej me sigurim vullnetar)", - theksohet në faqen zyr-

### SIGURIM VULLNETAR PËR VITIN KORRENT

Instituti i Sigurimeve

tare të ISSH-së. Gjithsesi, pagesat e vitit korrent mund të bëhen edhe me shumëfishin e kuotës minimale mujore, 5 184 lekë, deri në kufi të pagës maksimale.

### SIGURIM VULLNETAR PËR MË SHUMË TË ARDHURA

Sigurim vullnetar për më shumë të ardhura mund të paguajnë të gjithë personat ekonomikisht aktivë të

vetëpunësuar, të punësuar dhe punëdhënësit, të cilët duhet të jenë të siguruar si të fillë në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Ky sigurim bëhet vetëm për vitin korrent në kufijtë e pagave minimale dhe maksimale, 24 000 dhe 105 850 lekë (qytetarit ka të drejtë të zgjedhë një pagë brenda këtij kufiri). ISSH bën me dije se personat e vetëpunësuar sigurohen me pagë minimale mujore 24 000 lekë e mbi këtë pagë çdo person ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e pagës maksimale 105 850 lekë. Ndërkohë, punëmarrësit që sigurohen në bazë të kontratës të nënshkruar me punëdhënësin kanë të drejtë të sigurohen vullnetarisht për më shumë të ardhura mbi pagën që ata marrin deri në nivelin e pagës maksimale 105 850 lekë. Çdo punëdhënësi që sigurohet nën nivelin e pagës maksimale ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e kësaj page, ndërsa çdo kontribuues vullnetar për vitin korrent ka të drejtë të sigurohet për më shumë të ardhura.

### PERIUDHAT E KALUARA

Sigurim vullnetar për periudhat e kaluara mund ta paguajnë të gjithë shtetasit shqiptarë që:

- Kanë mbushur moshën 18 vjeç.
- Që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfutim nga skema e sistemit të detyrues.
- Shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha pasuniversitare është me pagesë.
- Ky sigurim për periudhat e kaluara mund të bëhet edhe nga shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar si dhe personat që kanë lënë shtetësinë.
- Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa.
- Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar, por në këto pagesa nuk aplikohen zbritjet.

### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PËRMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 2/69+2-14. LLOJI 'APARTAMENT'. VOLUMI 8, FAQE 218, SIPERFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NE PRONESI TE Z. ILLMI SULA.

ÇMIMI 5.900.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.11.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262966 .

### ZYRA PËRMBARIMIT GJYQESOR KORCE

1-Me date 01.11.2018, ditën e Enjte ora 16.00 perfundon ankandi i pare per pasurine: (Apartament) me nr.pasurie 4/267+1-2.zk.8662.vol.1.fq.227 me siperfaqe prej 52 m2 regjistruar ne Z.V.R.P.P. Korce, e ndodhur ne adresen Lagjia nr.4,Rr."Todi Vogli"pallati nr.4,Shk.a.K.4,Korce

2-Cmimi fillestar me te cilin fillon ankandi eshte 1.360.000.leke.

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Zyres se Permbarrimit Korce Me adrese Bulevard "Republika" Keshilli Qarkut,Kati 4, Korce tel.082245621

## UNIVERSITETI "LUARASI" BASHKËPUNIMI

Aktivitet me Këshillin Rinor të Ballkanit, Mani: Mundësi e shkëlqyer për studentët

Voltiza Duro

Në kuadër të bashkëpunimeve të vazhdueshme me organizatat ndërkombëtare, Universiteti "Luarasi" ka organizuar një aktivitet të përmasave globale, me synim edukimin dhe trajnimin e studentëve. Ky institucion elitari i arsimit të lartë, këtë herë ka përzgjedhur që të diskutojë tema të nxehta mbi diplomacinë, ekonominë dhe politikën sociale me përfaqësuesit e Këshillit Rinor të Ballkanit. Programi 5-ditor u ka ofruar mundësinë studentëve të "Luarasit" që të shkëmbejnë informacione me të rinjtë profesionistë nga shtete të ndryshme të botës. Në përfundim të aktivitetit, studentët u pajisën me certifikata, ndërkohë që Mateo Veliu, student i Ekonomikut të "Luarasi" mori çmimin e Performancës.

### BASHKËPUNIMI

Ky bashkëpunim mundëson që studentët e Universitetit "Luarasi" të jenë pjesë e "Balkan Youth Council", të thyjnë barrierat e kufijve dhe të krijojnë një rrjet të mirë bashkëpunimi. Aelita Mani, drejtuese e Departamentit të Administrimit Biznesit pranë Fakultetit Ekonomik në "Luarasi" tregon se aplikimi i programeve të tilla nxit frymën e debatit e krijon përvojë të shkëlqyer për studentët. "Universiteti 'Luarasi' në vazhdimin e praktikave më të mira për studentët e tij, 'network'-un dhe trajnimin e tyre, që në fillim të vitit akademik ka nisur me një program 5-ditor për trajnimin e studentëve në kuadër të bashkëpunimit që ka me 'Balkan Youth Council'. Ky program jep mundësi për studentët e 'Luarasit' që të jenë aktivë në diskutime të temave të ndryshme jo vetëm rajonale, por edhe botërore mbi ekonominë, mjedisin, diplomacinë e politikën sociale", thekson Mani. Kjo e fundit më tej shton se programe të tilla ndihmojnë studentët që të shkëmbejnë njohuri e eksperiencë. "Luarasi" nxit frymën e debatit, ofron mundësi për shkëmbimin e informacioneve me studentët nga vende të ndryshme të botës, e kjo shërben si një përvojë e shkëlqyer. Kështu, thyhen barrierat e kufijve dhe krijohet një rrjet bashkëpunimi me studentët nga vende të ndryshme të botës", - shton shefja e departamentit të Administrimit-Biznesit pranë këtij institucioni elitari të arsimit të lartë.

### PËRSHTYPJET E STUDENTËVE TË HUAJ

Vetë pjesëmarrësit nga shtete të ndryshme të botës si Tunizia, Libia, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Pakistani etj., shprehën tejet të kënaqur mbi bashkëpunimin me "Lu-

# "Luarasi", program 5-ditor me ekspertë nga shtete të ndryshme të botës

Çmimin e Performancës e merr student i Mateo Veliu



### CERTIFIKIMI

Në përfundim të aktivitetit 5-ditor, studentët u pajisën me certifikata, ndërkohë që Mateo Veliu, student i Ekonomikut të "Luarasi" mori çmimin e Performancës. Nëpërmjet programeve të tilla ndërkombëtare, "Luarasi" vazhdon të mbetet një ndër liderët e arsimit të lartë në vend.

### AELITA MANI

"Luarasi" nxit frymën e debatit, ofron mundësi për shkëmbimin e informacioneve me studentët nga vende të ndryshme të botës, e kjo shërben si një përvojë e shkëlqyer. Kështu, thyhen barrierat e kufijve dhe krijohet një rrjet bashkëpunimi me studentët nga vende të ndryshme të botës", - shton Aelita Mani



### MAZEN FAKIH

"Jam Mazen Fakih nga Libia dhe punoj si inspektor në Ministrinë e Punëve Sociale. Është një nder për mua të jem në Shqipëri, por veçanërisht në Universitetin 'Luarasi'. Studentët dhe stafi pedagogjik janë shumë miqësorë dhe u ndjeva më shumë sikur isha në shtëpi", - tregon Fakih.



### SABRINA JAMAL BRAHMI

"Në Universitetin 'Luarasi' më bëri më shumë përshtypje arkitektura, organizimi, stafi i përgjegjshëm dhe studentët e mrekullueshëm", thotë Sabrina Jamal Brahmi.



arasin". "Jam Mazen Fakih nga Libia dhe punoj si inspektor në Ministrinë e Punëve Sociale. Është një nder për mua të jem në Shqipëri dhe në qytetin e bukur të Tiranës, por veçanërisht në Universitetin 'Luarasi'. Studentët dhe stafi pedagogjik janë shumë miqësorë dhe u ndjeva më shumë sikur isha në shtëpi", - tregon Fakih. Ndërsa për mësuesen nga Tunizia, infrastruktura, stafi pedagogjik dhe studentët bëjnë diferencën në universitetin "Luarasi". "Në Universitetin 'Luarasi' më bëri më shumë përshtypje arkitektura, organizimi, stafi i

përgjegjshëm dhe studentët e mrekullueshëm", thotë Sabrina Jamal Brahmi. Ndërsa përfaqësuesi i Egiptit në BYC tregon se mënyra analitike e të menduarit të studentëve të "Luarasit" i ka bërë më shumë përshtypje. "Universiteti është me të vërtetë shumë i bukur dhe studentët janë shumë kurajozë dhe të motivuar për të marrë pjesë në këtë program. Kjo është me të vërtetë mbresëlënëse", - thotë Andrea Danova nga Bullgaria. Sipas ekspertëve të huaj, studentët e Universitetit "Luarasi" kanë aftësi të shkëlqyer analitike e kjo falë stafit aka-

demik të mrekullueshëm. "Kam takuar këtu studentë shumë interesantë dhe jam i mahnitur rreth mënyrës kritike që ata përdorin për analizimin e çështjeve të ndryshme në Shqipëri", - thekson Mudassar Munir. "Më pëlgen shumë Universiteti 'Luarasi'. Pashë shumë studentë këtu dhe ajo që më bëri përshtypje është fakti që ata janë shumë të lumtur e të buzëgështur. Kjo nënkupton që janë shumë të kënaqur me profesorët", - tregon Fatima Pobrklie nga Bosnje-Hercegovina.

### STUDENTËT E "LUARASIT"

Kombinimi i praktikës me teorinë është një nga strategjitë më të fuqishme të "Luarasit". Vetë studentët e shikojnë këtë institucion si zgjedhjen perfekte për të bërë realitet ëndrrat e tyre, për një të ardhme profesionale të sigurt. "Unë jam Antonio Muka

dhe jam student i vitit të parë në degën Administrim-Biznes në Fakultetin Ekonomik në Universitetin 'Luarasi'. Jam shumë i lumtur që zgjodha këtë universitet, pasi më janë bërë ëndrrat realitet dhe me shumë kënaqësi do të jem pjesëmarrës edhe në aktivitetet e tjera që do të zhvillojë 'Luarasi', - thekson Muka.

### CERTIFIKIMI

Në përfundim të aktivitetit 5-ditor, studentët u pajisën me certifikata, ndërkohë që Mateo Veliu, student i Ekonomikut të "Luarasi" mori çmimin e Performancës. Nëpërmjet programeve të tilla ndërkombëtare, "Luarasi" vazhdon të mbetet një ndër liderët e arsimit të lartë në vend, duke zgjeruar çdo ditë e më shumë rrjetin e të rinjve dhe duke parapërgatitur studentët për tregun global të punës.

### NJOFTIM

Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k, propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORCA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impiantit të Trajimit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k. për realizimin e vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e licencuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjës Publike për të bërë publike rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mbledhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Dëgjësja Publike do të mbahet në datën **26 Tetor 2018** në orën **12:00** në sallën e takimeve tek **"Grand Hotel Korça"**



Dështojnë operacionet e forcave speciale në Durrës dhe Sarandë, dyshohet se u dekonspiruan

# "Shpëtojnë" Lul Berisha dhe Klement Balili

Pranga "bosit" të Shijakut, Astrit Avdylit dhe vëllezërve të tij

Policia e Shtetit është ngritur në këmbë duke kryer një aksion antidrogë në të gjithë vendin. Shumë qytete nga veriu në jug janë në alarm pas pranisë së forcave të shumta RENEA. "Balkanweb" raportoi dje se u krye një aksion për kapjen e Lul Berishës, me policinë që ka bastisur në shtëpinë e tij, edhe pse ky i fundit nuk është gjetur. Mediat shkruajnë se ekziston një urdhër arresti për Lulzim Berishën, ish-kreun e bandës së Durrësit. Dyshohet se operacioni është dekonspiruar.

Nërkohë, po mbrëmë ka nisur një operacion për kapjen e Klement Balilit, që akuzohet se ka trafikuar 600 kilogramë hashash. Policia lokalizoi vendndodhjen e tij, por deri në orët e para të mëngjesit e pati të pamundur ta ndalojë të shumëkërkuarin. Në fokus të policisë ishte goditja e grupeve kriminale në trafik drogash e armësh. Po dje u arrestua edhe i ashtuquajtur "Bosi" i Shijakut, Flamur Avdyli. Avdyli është arrestuar nga forcat RENEA bashkë me dy persona të tjerë, njëri me inicialet H.H., me akuzën e trafikut ndërko-



mbëtar të lëndëve narkotike. Në pranga kanë rënë edhe Astrit Avdyli, Jasin Avdyli, Fatos Llaftiu, Shkelqim Avdyli, Shaqir Gjepali.

### OPERACIONI NE SHIJAK

Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë dhe ato RENEA,

mbështetur dhe nga blutë e Durrësit kanë ushtruar një krehje të zonës së Shijakut, për të ndaluar persona me precedentë të mëparshëm penalë në fushën e narkotikëve dhe veprave të tjera të kundraligjshme. Bëhej fjalë për rreth 60 persona të ndaluar, disa prej

të cilëve, emra të njohur për policinë dhe botën e kriminit. Të njëjtat burime thanë se në këtë superoperacion kanë marrë pjesë 1000 efektivë të policisë. Mësohet se ndër të arrestuarit janë Shkelqim Avdyli, Flamur Avdyli, Astrit Avdyli, Jasin Avdyli, Sha-

**OPERACIONI**  
Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë dhe ato RENEA, mbështetur dhe nga blutë e Durrësit kanë ushtruar një krehje të zonës së Shijakut, për të ndaluar persona me precedentë të mëparshëm penalë në fushën e narkotikëve dhe veprave të tjera të kundraligjshme. Bëhej fjalë për rreth 60 persona të ndaluar, disa prej të cilëve, emra të njohur për policinë dhe botën e kriminit.

### TE SHOQUARIT

1. SHKELQIM AVDYLI
2. FLAMUR AVDYLI
3. ASTRIT AVDYLI
4. JASIN AVDYLI
5. SHAQIR GJEPALI
6. FATOS LLAFTIU

pritej të zhvillohej në Shijak, i cili është një ndër qytetet më të lakuara për aktivitetet kriminale ndër vite dhe që janë shënuar një sërë ngjarjesh me karakter kriminal. Po ashtu, burimet thanë se ka të arrestuar nga i gjithë vendi e jo vetëm nga Shijaku. Flamur Avdyli, një prej të arrestuarve, është një emër i njohur, pasi është pronar i disa bizneseve në Shijak dhe Durrës. Flamur Avdyli është emigrant prej vitesh në Gjermani.

qir Gjepali, Fatos Llaftiu. Nërkohë që operacioni policor u bë pa detaje nga ana e Policisë së Durrësit, e cila ishte thjesht mbështetëse në operacion, pasi urdhri erdhi nga kryeqyteti. Po ashtu, të njëjtat burime bëjnë me dije se ky operacion ka disa ditë që

## Dyshimi, u përfshi në ngjarje duke fshehur armët e kriminit

### Arrestohet Redi Popesku, i zoti i lokalit ku u plagos Ervis Martinaj

Dëshmia e Redi Popeskut për përplasjen me armë mes grupeve të Ervis Martinajt dhe të Elvis Matajt nxori si motiv të ngjarjes ngacmimin e Elvana Gjatës. Por sa më shumë zbuloheshin detaje të ngjarjes, aq më i dyshimtë dukej ky motiv i kriminit, ku mbeti i vrarë Fabian Gaxhaj dhe të plagosur Ervis Martinaj dhe Elion Hate. Në arrati janë ende komando Marviol Billo dhe Ervin Mataj, të dyshuar për vrasjen në rrethana ende të paqarta.



zjarrit, ai u fsheh pas banakut dhe në dalje është përjekur të japë ndihmën e parë për të plagosurit.

"Mbas kësaj krime unë jam hedhur direkt poshtë banakut. Në këtë kohë kam dëgjuar krismat e armëve që vazhdonin. Kur krismat pushuan, afër banakut ka ardhur Vis Martinaj zvarrë, të cilin e pashë se ishte i plagosur në qafë dhe e kam marrë e kam zbritur deri poshtë shkallëve, ku e kam drejtuar

ar drejt taksive. Dua të shpjegoj se kur dola nga banaku, të gjithë personat kishin ikur, përveçse personit që ishte i vrarë dhe një person tjetër afër derës, që ishte duke u përpulitur. Më pas unë kam vazhduar të rri në trotuar me shishe në dorë për t'i kthjelluar. Më pas kam lënë shishen në trotuar dhe jam kthjelluar. Në këtë moment kam parë dy motorë policie dhe u kam ngritur dorën, duke i njoftuar për atë që kishte ndodhur. Më pas kam hyrë brenda së bashku me forcat e policisë. Pasi kanë mbaruar të shtënat në lokal, unë kam qenë i shtrirë poshtë banakut. Te vendi ku isha unë i shtrirë, ka ardhur Ervis Martinaj pranë meje dhe ai ishte i shtrirë dhe po më thoshte: 'Më çoj në spital'. Unë e pashë që po i dilte gjak nga qafa. Jemi ngritur të dy, Ervisi mbahej nga

krahu im. E kam shoqëruar deri te fundi i shkallëve dhe i kam thënë që merr një taksë. Ervisi iku në drejtim të lokalit 'KFC' dhe më pas nuk e pashë. Nërkohë që po shoqëroja Visin për ta nxjerrë nga lokali, te dera kryesore e dyqanit ishte dhe një djalë i shtrirë i plagosur, i cili kishte ardhur me Ervisin. Këtë djalin, kur jam kthyer përsëri në lokal, nuk e kam parë dhe nuk e di se nga iku. Edhe personi që ngeli i vrarë në lokal kishte ardhur me Ervisin, pra ishte shok apo shoqëruar i tij nuk di ta them". "Lapsi.al" shkruan se pikërisht në këtë skenë, kur nga lokali ishin larguar të dy grupet dhe kur ende ishin të shtrirë të plagosurit, dyshohet se Popesku është përfshirë në ngjarje duke fshehur armët e kriminit.

### ZOI DHIMA

## U vra në 1997, mbyllet përfundimisht dosja e ish-futbollistit të "Butrintit"

Prokuroria e Sarandës ka mbyllur përfundimisht pas më shumë se 21 vitesh dosjen e vrasjes së ish-futbollistit të "Butrintit", të mirënjohurit Zoi Dhima. Në vendimim e datës 17.10.2018, Gjykata e Sarandës, pas kërkesës së prokurorisë argumenton: "Gjykata konkludon që të pranojë kërkesën e organit të akuzës dhe të pushojë çështjen që i përket procedimit penal nr.02 të vitit 1998, pasi deli qartë se në rastin e veprës penale 'Vrasje me dashje' dhe 'Armëmbajtje pa leje', parashikuar nga neni 76 dhe 278 i Kodit Penal, ndjekja penale për këtë veprë penale tashmë është parashikuar dhe si e tillë duhet të pushojë. Ngjarja e rëndë, sipas vendimit të gjykatës, ka ndodhur në datën 18.05.1997, rreth orës 12:00, në lagjen nr.1 të qytetit të Sarandës, në afërsi të një lokali, ku është vrarë me armë zjarri nga persona të paidentifikuar shtetasit Zoi Jani Dhima, banues në Gjashtë-Sarandë. Plumbat kanë ardhur nga një skaf që erdhi nga deti dhe në ngjarje ka mbetur i plagosur edhe shtetasi Leonadro Lapa. Pasi janë kryer veprimet hetimore dhe nuk është arritur të identifikohet autori i vrasjes, me vendimim e datës 13.07.1998, është pezulluar kjo çështje dhe i ka kaluar për veprime hetimore Komisarriati të Policisë Sarandë, për shkak se nuk është bërë i mundur identifikimi i autorit të kryerjes së veprës penale. Në referencë të nenit 66, paragrafi i parë, germa b, të Kodit Penal sipas të cilit "Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë".

# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS





Kamenos: Mos prisni që të rrëzohet qeveria, nuk e mbështesim marrëveshjen

# Rusia nuk pranon emrin e ri të Maqedonisë

## Debati me Kotzias, reagon ministri grek i Mbrojtjes

### AMBASADA RUSE

"Rusia e ka njohur Republikën e Maqedonisë me emrin e saj kushtetues më shumë se para 26 vjetësh dhe nuk do ta ndryshojë qëndrimin e saj", thuhet në profilin e ambasadës ruse në Shkup.

Rusia nuk do ta njohë emrin e ri të Maqedonisë, pas marrëveshjes mes Athinës dhe Shkupit. Lajmi bëhet me dije nga Ambasada e Rusisë në Shkup përmes një postimi në "Twitter". Sipas ambasadës, Rusia e ka njohur Republikën e Maqedonisë me emrin e saj kushtetues para 26 vjetësh. "Rusia e ka njohur Republikën e Maqedonisë me emrin e saj kushtetues më shumë se para 26 vjetësh dhe nuk do ta ndryshojë qëndrimin e saj", thuhet në profilin e ambasadës ruse në Shkup. Kujtojmë se tri ditë më parë Kuvendi i Maqedonisë ka miratuar me 80 vota pro nismën për ndryshimet kushtetuese, duke hapur rrugë ndryshimit të emrit nga Republika e Maqedonisë në Republika e Maqedonisë së Veriut. Ndërkohë që vetëm para disa ditësh, Nikos Kotzias, i dorëhequr nga posti i ministrit të Jashtëm në Greqi, ka dorëzuar të shtunën detyrën të kryeministrit Alexis Tsipras. Gjatë ceremonisë së dorëzimit të detyrës, Kotzias tha se Greqia është gati të zgjerojë ujërat e saj territoriale në krahun perëndimor, nga 6 në 12 milje detare. Në njoftimin për mediat, thuhet se zgjerimi i zonës detare bëhet nga ishujt Diapontia, një grup ishujsh të vegjël në detin Jon, ku bën pjesë edhe Otonoi e deri në Antikythera, një ishull që shtrihet mes Peloponezit dhe Kretës. "Ky është një zgjerim i rëndësishëm politik i sovranitetit të vendit, për herë të parë që prej kohës kur Greqia përfshiu grupin e ishujve Dodecanese (më i madhi i të cilit është ai i Rodosit)", tha Kotzias, duke shtuar se dekretet presidenciale janë gati. Konventa UNCLOS i jep të drejtë çdo shteti për të deklaruar në OKB deri në 12 milje det territorial për sa kohë kjo mund të lejohet nga shtrirja gjeografike. Në kushtet kur shtetet kanë mes tyre më pak se 24 milje det territorial, atëherë ndarja bëhet bazuar në të drejtën ndërkombëtare, duke bërë korrigjimin e nevojshme sipas konfigurimit të bregdetit dhe rrethanave të veçanta. Burime nga Ministria e Jashtëm thanë: "Pari mi i 12 miljeve mund të aplikohet vetëm në rastet kur deti territorial i një shteti

nuk mbivendoset me detin territorial të shtetit fqinj, ku distanca është më e vogël se 24 milje". Nisur nga kjo, duket qartë se çështja e zgjerimit të gjerësisë së detit territorial të Greqisë është një çështje e së drejtës ndërkombëtare, e cila ia njëh këtë mundësi të gjitha shteteve, ashtu siç edhe Shqipëria e ka bërë një gjë të tillë prej vitesh. Por, distanca e 12 miljeve nuk zbatohet në gjirin e Sarandës apo në zonat e tjera të detit territorial mes dy vendeve, pasi distanca në këto zona është nën 12 milje. Nga ana tjetër, një deklaratë vjen nga ministri



Shkupi

grek i Mbrojtjes, Panos Kamenos: "Mos prisni që qeveria të bjerë". Kështu u shpreh ai në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të partisë "Grekët e pavarur" në Selanik. Ministri grek i Mbrojtjes foli pas debatit që pati me ish-ministrin e Jashtëm, Nikos Kotzias për marrëveshjen me

Maqedoninë. Ai e përshkroi si të ndershëm dhe të hapur bashkëpunimin e partisë së tij "Grekët e Pavarur" me SYRIZA-n e Alexis Tsipras. Madje, ai shtoi që askush nuk duhet të presë rrëzimin e qeverisë. "E themi hapur dhe publikisht për çfarë jemi dakord dhe për çfarë nuk

### PANOS KAMENOS

"E themi hapur dhe publikisht për çfarë jemi dakord dhe për çfarë nuk jemi. Sikurse tha edhe z. Tsipras, çështja e Shkupit nuk ekzistonte në bashkëpunimin e SYRIZA me "Grekët e pavarur", ka thënë Kamenos.

jemi. Sikurse tha edhe z. Tsipras, çështja e Shkupit nuk ekzistonte në bashkëpunimin e SYRIZA me "Grekët e pavarur". Ne kemi një pozicion të qartë dhe publik, nuk mund të pranojmë asnjë emërtim që përmban termin Maqedoni. Ne nuk do të tërhiqemi dhe SYRIZA nuk na ka kërkuar që të tërhiqemi. E kemi thënë që në fillim se nuk do ta mbështesim marrëveshjen e Prespës. Qëndrimi ynë në qeveri do të jetë deri kur ligji të vijë në Parlament. Do të flasin përsëri në mars", tha ministri Kamenos.

## Thaçi: SHBA mbështetnin korrigjimin kufitar me Serbinë

### Do nënshkruaj marrëveshjen, nëse ndërkombëtarët garantojnë njohjen

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi gjatë një interviste në një emision televiziv ka konfirmuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbështesin idenë e tij për korrigjimin kufitar me Kosovën dhe Serbisë, raporton "zëri.info". "Realisht unë i besoj projektit për korrigjimin e kufijve, duke përfshirë kështu Preshevën dhe Bujanovcin. Ata ma kanë propozuar këtë ide në kabinetin tim. Kanë qenë këshilltarët e tyre. Unë kam thënë që nëse keni seriozisht, pranoj. SHBA-të do ta mbështesin çdo gjë që është në interes të Kosovës, qoftë edhe korrigjimin e kufijve", - ka thënë Thaçi në "Oksigen". Ai po ashtu ka deklaruar se do ta nënshkruajë marrëveshjen me Serbinë vetëm nëse SHBA dhe BE



Hashim Thaçi

do të garantonin që Serbia do ta njohë Kosovën, që Rusia ta tërheq veton dhe që Kosova të pranohet në NATO dhe BE. "Nëse kemi garancinë nga SHBA-të dhe BE për njohje nga Serbia, pastaj për heqjen e vetos nga Rusia në Këshillin e

Sigurimit dhe për anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe BE, unë do ta nënshkruaj marrëveshjen, por vetëm nëse kemi garanci të plotë", - ka thënë ai. I cili ka ripërsëritur edhe njëherë që Kosova nuk mund të anëtarësohet as në NATO e

### THAÇI

"Nëse kemi garancinë nga SHBA-të dhe BE-ja për njohje nga Serbia, pastaj për heqjen e vetos nga Rusia në Këshillin e Sigurimit dhe për anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe BE, unë do ta nënshkruaj marrëveshjen, por vetëm nëse kemi garanci të plotë", - ka thënë Thaçi.

as në BE pa nënshkruar një marrëveshje me Serbinë. "Nuk ka anëtarësim as në NATO e as në OKB e BE pa marrëveshje ligjërish obligative me Serbinë, që do të nënkuptonte njohjen reciproke", ka thënë Thaçi.

### SHKURT

#### Taivan, treni del nga shinat, 22 viktima

Të paktën 22 persona mbetën vrarë dhe 170 të tjerë u plagosën si pasojë e një aksidenti hekurudhor në Taivan. Treni me 366 persona në bord po udhëtonte nga kryeqyteti Taipei drejt një qyteti tjetër, kur të 8 vagonët e tij dolën nga shinat. Bilanci i viktimave me gjasë mund të jetë edhe më i madh, pasi shumë prej të plagosurve janë në gjendje të rëndë. Ende nuk dihet me siguri se cili është shkak i aksidentit të rëndë, por dëshmitarët thanë për mediat se kishin dëgjuar një zhurmë të madhe dhe kishin parë tym pak çaste përpara ngjarjes. Autoritetet vendase njoftuan se treni i shpejtësisë së lartë ka vetëm 6 vjet në punë dhe ishte në gjendje të mirë teknike, çka rrit dyshimet se ngjarja mund të jetë shkakuar nga ndonjë gabim njerëzor.

#### Mijëra emigrantë strehohen në Meksikë

Mijëra emigrantë që kanë udhëtuar drejt hyrjes për në Shtetet e Bashkuara kanë mbetur të bllokuar në Meksikë në kufirin me Guatemalën, raportojnë autoritetet. Më shumë se 5,100 emigrantë janë regjistruar në tri strehimore në kufirin me Meksikën, ndërka 2,000 të tjerë kanë qëndruar gjatë natës në sheshin e qytetit. "Është mbushur plot. Nuk mund të ecësh, çka shumë njerëz. Deri më tani të gjithë janë të qetë", deklaruan autoritetet. Në një njoftim, qeveria e Meksikës tha se rreth 900 emigrantë kanë arritur të paautorizuar, ndërka 640 prej tyre kanë hyrë në procedurë për shkak të kalimit të kufirit ndërkombëtar që ndan Guatemalën dhe Meksikën. Më herët presidenti i Hondurasit dhe ai i Guatemalas thanë se rreth 2,500 emigrantë kanë kaluar transit në këto vende, shumica prej të cilëve kanë udhëtuar pa pagesë, me autobus të ofruar nga policia.

#### Francë, nxënësi i drejton armën mësueses

Një ngjarje shokuese ka ndodhur në një gjimnaz në Francë, ku një nxënësi i ka drejtuar armën mësueses. Pasi mësuesja i kishte vendosur mungesë i ka drejtuar në kokë një pistoletë me ajër, por fatale nga ajo distancë. Ai i kërkonte anulimin e mungesës, ndërka të tjerë djem dëfreheshin me skenën. Ministri i francez i Arsimit, Jean-Michel Blanquer, e dënoi ashpër aktin dhe shprehu solidaritetin me mësuesen. Agresori dhe adoleshenti tjetër që shfaqet në video u arrestuan.

Christiani ishte djali i dëshiruar i Sabine Lappes. Por djali i ëmbël një ditë u bë terrorist dhe shkoi të luftojë në Siri, ku edhe humbi jetën. Nëna e tij ka vendosur të rrëfejë historinë e tij për "Deutsche Welle".

## Nga Gjermania në "Shtetin Islamik", nëna e terroristit

Një të shtunë në mëngjes, në vitin 2015, herët në orën 05:45 bie zilja e telefonit në shtëpinë e Sabine Lappes. Kush telefonon kaq herët... ishte ngritur e zemëruar ajo. Christiani, djali i saj 27-vjeçar ishte në telefon. "Mama jemi në Turqi, po presim për të na çuar në Siri", i jep lajmin ai. Bashkë me gruan Yasmina, ai kishte vendosur brenda natës të bashkohej me milicët e të ashtuquajturit "Shteti Islamik". Sabine Lappe iu lut që të kthehej. "Jo, nuk kthehemi, do të shkojmë atje, ku është më e lartë fjala e Allahut", më tha ai, kujton Sabine Lappe.

Sabine Lappe është një grua rreth të 50-ve, që jeton vetëm në një banesë me dy dhoma në Dortmund. Fotografia të Christianit nuk ka nëpër mure, vetëm një kaftan i tij, të cilin ajo ka vendosur ta lërë të varur pas dere përgjithmonë. Sabine Lappe nuk del me dëshirë jashtë shtëpisë. Jashtë ajo është nëna e terroristit. Edhe pse askush nuk mban zi për të, ajo thotë: "Unë e dua tim bir, edhe pse nuk mbeti asgjë nga ai Christiani që ishte".

### KONVERTIM NËNË E BIR

Christian ishte një fëmijë inteligjent, me dëshirë për të mësuar, çapkën - rrëfen nëna e tij. Por fëmijëria e tij nuk ishte e lehtë. Christian u rrit pa baba, më vonë ai ra në shoqëri të keqe, u bë i varur nga droga, megjithatë Sabine nuk e la kurrë vetëm të birin. Kur ishte adoleshent, Christian u sëmur dhe askush nuk e gjente dot diagnozën. Në moshën 20-vjeçare, një natë ai ka pasur kaq shumë dhimbje barku, sa që Sabine Lappe vendos të thërrasë urgjencën. Mjekët konstatojnë një inflamacion kronik të

zorrës së trashë, Morbus Crohn.

Pasi i doli narkoza, Christiani bëri një premtim, kujton Sabine Lappe. Ai donte të falënderonte Zotin për këtë shans të dytë të jetës. Deri në atë kohë, Christiani nuk e njihje aspak fenë, aq më pak salafizmin. Familja e tij ishte katolike, edhe pse jo praktikuese. Pas disa operacioneve, Christiani undje gjithnjë e më mirë. Ai vendosi të rikthehej në shkollë, të mbaronte maturën dhe më vonë të studionte psikologji. Por në shkollë u njoh me disa djem marokenë dhe turq, djem që i rrëfenin me entuziazëm për fenë islame. "Një ditë ai erdhi në shtëpi dhe më tha se po mendon të konvertohet". Ishte viti 2012, kujton nëna. Sabine Lappe në këtë moment ndodhej vetë në një krizë personale, pas vdekjes së partnerit të saj. Edhe ajo vetë ishte në kërkim të kuptimit të jetës. Kjo ishte arsyeja e afërimit me islamit. Gjashtë muaj pas djalit, u konvertua edhe Sabine Lappe në fenë myslimane. Ajo thotë se besimi e bëri një "njeri të ekuilibruar".

### DIFERENCAT E PARA

Sabine Kappe kur del jashtë sh-



tëpisë mbulohej, po jo me nikab. Fytyrën e mban zbuluar. Nuk shkon - thotë ajo - jemi gjithsesi në Gjermani. Por në këtë pikë filluan grindjet me djalin. "Ai mori shumë shpejt një qëndrim radikal", kujton Sabine. Ai zemërohej, kur nëna shkante në treg, bisedonte me shitësin dhe i jepte madje edhe dorën. "Kjo nuk lejohet mama, kjo gjë është harram, e ndaluar", nervozohet Christiani. Por këtë nuk e lejonte Sabine Lappe. "Unë ia jap dorën kujt do që mendoj se duhet t'ia jap, kështu është këtu, një myslimani jo.

Por zotit Muller, ku blej prej 15 vitesh domatet nuk mund t'i them papritur, më vjen keq, nuk ta jap më dot dorën, se jam bërë myslimane".

### NJË TAKIM ME PASOJA

Pak para maturës, në vitin 2014, Christiani njihet me Yasminën, gruan e tij të mëvonshme. Një vajzë marokene-gjermane nga një familje me probleme, thotë Sabine. "Në të vërtetë unë i njoha ata të dy me njëri-tjetrin". Sabine Lappe vonë e kuptoi, se Yasmina kërkonte të martohej e të kishte dikë, me

të cilin mund të shkonte në Siri. "Christiani ra plotësisht në dashuri me këtë vajzë, që e pranonte ashtu siç ishte. Me puçrrat, me sëmundjen Morbus Crohn dhe qëndrimin në spitale". Një gjysmë viti më vonë, dy të rinjtë martohen në një xhami në Frankfurt. Me ndërrimin e viteve 2014-2015, Sabine Lappe dëgjo se Christian dhe Yasmina donin t'i bashkoheshin IS-it, kujton ajo. "Nuk e besova, ajo ishte ende një fëmijë", thotë Sabine. Por të dy kishin filluar ndërkohë përgatitjet për t'u larguar nga Gjermania. Christian njihet djem nga skena salafiste në Gjermani. Para largimit nga vendi, ai ishte vënë edhe në fokus të Mbrojtjes Kushtetuese Gjermane, raporton Sabine Lappe. Pas largimit në Siri, kontakti u vështirësua. Herë pas here Sabine Lappe telefononte me djalin, më pas shkruanin mesazh në "Whatsapp". Ishte Christiani ai që shkruante i pari me njëri-tjetrin. Sabine Lappe vonë e kuptoi, se Yasmina kërkonte të martohej e të kishte dikë, me

## Bankierë! Investimi më i sigurt

është shëndeti juaj!

Të gjitha përfitimet në një zgjidhje, me sigurimin Jetë dhe Shëndet Cash Plan! Siguroni veten dhe familjen tuaj, duke filluar nga 85 euro në vit/person dhe përfitoni mbulim për ndërhyrje kirurgjikale, vizita, analiza, medikamente, etj. deri në 25,000 Euro/vit.

- Sigurim Jete
- Checkup mjekësor vjetor
- Mbulim të shpenzimeve shëndetësore për sëmundje dhe aksidente
- Zbritje deri në 60% në spitalet dhe klinikat private pjesë të rrjetit mjekësor SiCRED

**SIGURIMI  
JETË dhe SHËNDET  
CASH PLAN**

**SiCRED**  
Shoqëri Sigurimi Jete

Për të blerë policën, kontaktoni me SiCRED në: **Tel: +355 4 22 37 549 | Cel: +355 69 20 84 026 | e-mail: shitje@sicred.com.al**





## MJEKU UROLOG DHE SEKSOLOG



Kim Drasa:  
Kombinimi që shpëton jetën  
e pacientëve nga kanceri i  
vezikës urinare

## KESHILLA



Kura popullore  
që trajton mëlçinë e  
prekur nga hepatiti C

# YLLI MERJA:



◆  
Mjeku  
popullor:  
Ja si ta  
përdorni  
bimën  
çudibërëse  
për uljen e  
inflamacionit

## Luftoni ankthin e stresin me lulen e basanit

"Ndhmon në kurimin  
e problemeve me stomakun"

**Mënyra të thjeshta dhe efikase për të eliminuar kollën**

Voltiza Duro

Të gjithë ata që vuajnë nga ankthi apo stresi, tashmë mund të përdorin një kurë me bimë medicinale dhe aspak të kushtueshme. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku popullor, Ylli Merja tregon se lulja e basanit luan një rol të rëndësishëm në organizmin e njeriut. Sipas tij, kjo bimë ka efekte në të gjithë organizmin dhe ka një përdorim shumë të gjerë. Ndikon në sistemin e tretjes, ka efekte qetësuese në organizëm, prandaj ndihmon në ngërçet e stomakut dhe ndihmon në djegiet e tij gjithashtu. Lulja e basanit ndihmon në shërimin e ulçerës dhe gastritit, prandaj këshillohet të përdoret pothuajse çdo ditë për rreth 45 ditë nga individët që vuajnë nga stomaku.

Çfarë është lulja e basanit dhe ku mund ta gjejmë atë?

Lule basani është bimë barishtore shumëvjeçare e familjes Hypericaceae (Guttiferae). Në vendin tonë kjo është një bimë që rritet gjerësisht në zonat e ulëta. Periudha që mblihet lule basani është në fund të majit dhe në fillim të qershorit. Bima mund të përdoret e thatë, ose e njomë. Kur është e njomë, sasia e bimës që përdoret duhet përgjysmuar, pasi përbërësit kimikë janë më të fuqishëm në bimën e njomë. Kësaj bime i përdoren vetëm majat e lulëzuara për veti kurative. Kjo bimë rritet e gjatë deri në 50 cm, por pasi mblihet, pritet rrënja e bimës dhe një pjesë e kërcellit që nuk përmban lule (rreth 20-30 cm të gjata) dhe thahen në hije.

**Cilët janë përbërësit kimikë të kësaj bime?**

Lule basani përmban shumë përbërës fitokimikë. Ndër këta, në sasi më të mëdha gjenden derivatet e floriglucinolinit në sasinë 0.2-4%, flavonoide (2-4%), taninë, proantocianidina, acid klorogjenik amino acide dhe vaj esencial (0.1-0.3%).

Mund të përmendni disa prej **vetive kimike të lules së basanit?**

Lule basani është një bimë çudibërëse. Ka efekte në të gjithë organizmin dhe ka një përdorim shumë të gjerë. Ndikon në sistemin e tretjes, ka efekte qetësuese në organizëm, prandaj ndihmon në ngërçet e stomakut, ndihmon në djegiet e tij gjithashtu. Kjo bimë ndihmon në shërimin e ulçerës dhe gastritit e prandaj këshillohet të përdoret pothuajse çdo ditë për rreth 45 ditë nga individët që vuajnë nga stomaku. Nëse keni djegie apo kthim të ushqimit, bima ndihmon në rregullimin e funksionit të muskujve të stomakut, duke i qetësuar ato, duke sinkronizuar kështu mbylljen dhe hapjen e këtyre muskujve.



Mjeku popullor: Ja si ta përdorni bimën çudibërëse për uljen e inflamacionit

# Ylli Merja:

## Luftoni ankthin e stresin me lulen e basanit

*"Ndihmon në kurimin e problemeve me stomakun"*



Ylli Merja

**Si ndikon kjo bimë në uljen e inflamacionit të brendshëm?**

Lulja e basanit ndikon në rigjenerimin e mukozave të brendshme të organeve, kështu ul inflamacionin e brendshëm. Nëse konsumoni shumë kafe gjatë ditës, e cila rrit inflamacionin e organeve të brendshme dhe rrit gjendjen e hiperaktivizimit, mund të zëvendësoni një kafe me një gotë çaj me lule basani dhe kështu e ndihmoni trupin tuaj të qetësohet dhe të vazhdojë punën normalisht. **A ka ndonjë efekt lulja e basanit në sistemin nervor?**

**Si ndikon kjo bimë në uljen e inflamacionit të brendshëm?**

Bima ndihmon në qetësimin e sistemit nervor. Ndikon në qetësimin e ankthit dhe stresit, ndikon direkt në sistemin nervor duke e qetësuar atë, pa shkaktuar efekte anësore. Në rast se keni probleme me pagjumësinë apo keni një situatë stresuese, e cila ju ndikon në gjumin tuaj mund të përdorni çdo natë për 30 minuta deri në 1 orë para gjumit një gotë me çaj lule basani. Kjo ndihmon në një gjumë të qetë e në largimin e gjendjeve stresuese. Bima

ndikon në rregullimin e sekretimit të hormoneve nga truri, prandaj edhe ka efekte qetësuese. Kështu ndikon në rregullimin e menstruacioneve, sidomos tek femrat që kanë rregullime hormonale dhe kanë vonesë të ciklit menstrual. **Si mund të përgatitet vaji i basanit?**

Lulebasani përdoret e plotë, ose e copëtuar. Mund të përdoret si çaj, ose mund të përdoret vaji i bimës. Doza ditore për të rriturit është 2-4 gramë material biomor. Zakonisht, 1 lugë çaji në një gotë me ujë. Rekomandohet 1-2 gota në ditë para ushqimit. Për të përgatitur vaj basani veprimë kështu: merret lulja e basanit e njomë, priten me gërshërë vetëm lulet e bimës dhe hidhen në një enë qelqi, mbulohen komplet lulet me vaj ulliri dhe lihet përzierja në diell për 45 ditë. Pas 45 ditësh kullohet vaji dhe ruhet në errësirë. Nga ky vaj konsumohet 1 lugë gjelle në mëngjes çdo ditë përpara ushqimit. Vaji i lule basanit mund të përgatitet edhe me lulen e thatë të bimës, mjafton që përpara se ta futni në vaj lulet e bimës duhet të futen në ujë të valuar përpara për 2-3 minuta. Pastaj lihet të kullojë pak uji dhe futen menjëherë në vaj ulliri.

**A gjen përdorim të jashtëm kjo bimë?**

Vaji i lules së basanit përdoret edhe për përdorim të jashtëm. Përdoret në trajtimin e plagëve, djegieve dhe pezmatimeve të lëkurës. Vaji i lules së basanit është shumë i fuqishëm në mbylljen e plagëve, ndihmon në rigjenerimin e qelizave të mukozave të brendshme. Përdoret në kremra rigjenerues për plagë si dhe për rigjenerimin e kurimit e hemoroideve në fund të zorrës së trashë. Është ushqyes e rigjenerues i zorrës së trashë. Kremi kundër hemoroideve arrin të hyjë në thellësi të zorrës, pasi përthithet shumë shpejt nga zorra e trashë. Ky krem e ushqen, lubrifikon dhe mbyll plagët e brendshme në zorrë.

**Ku duhet të tregohet kujdes gjatë përdorimit të vajt të basanit?**

Siç theksova, vaji i lule basanit përdoret për lyerje të lëkurës, por lëkura e lyer nuk duhet të ekspozohet në dritën intensive të diellit. Pasi ndikon në formimin e njollave kafe në trup, nëse ekspozoheni në diell me vajin në lëkurë.



Mjeku urolog dhe seksolog: Sëmundja prek më së shumti meshkujt dhe të moshuarit

# Prof. dr. Kim Drasa: Kombinimi që shpëton jetën e pacientëve nga kanceri i vezikës urinare

*"Simptomat, kur duhet të kryeni ekzaminimin"*

Voltiza Duro

**K**anceri i vezikës urinare është një nga 11-të sëmundjet malinje në të gjithë botën. Incidenca e kancerit të vezikës urinare ka pësuar rritje gjatë këtyre 20 viteve të fundit. Kanceri i vezikës urinare është i katërti më tepër i zakonshëm tek meshkujt dhe i dhjeti tek femrat. Ky është një nga shkaqet më frekvente të vdekjeve nga kanceri. Incidenca është më e lartë në popullsinë e plakur, me një mesatare moshe nga 60-65 vjeç. Mjeku urolog dhe seksolog, prof. dr. Kim Drasa thekson për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare" disa nga mënyrat e trajtimit të sëmundjes.

Metoda profilaktike konsiston në përdorimin e një doze të vetme: Mitomycin C ose Doxorubicin, të jepen sa më shpejt të jetë e mundur, pas rezeksionit transurethral të tumorit vezikës urinare (TURBT) - koha ideale është brenda 6 orëve dhe jo më vonë se 24 orë, pasi është bërë rezeksioni (prerja) i tumorit (TURBT). Ndërkohë, metoda terapeutike përfshin dhënien e medikamenteve pacientit, të cilët nuk i është hequr komplet tumori me metodën e rezeksionit. Por në këtë rast është parë nga shumë klinika se kombinimi i Hypertermisë me Mitomycin C është më i përshtatshmi. Metoda adjunctive përfshin një kurs të kimioterapisë, e dhënë tek një pacient në rrezik të lartë recurrence, si rregull për të reduktuar numrin e përsëritjeve të kancerit. Tipikisht, këtu përfshihen 6 ose 8 instilacione (futje pikë-pikë) të Mitomycin C, në intervale javore. Në vazhdim, pas disa javësh nga kjo metodë bëhet kontrolli me Cystoskope, për të vlerësuar rezultatit.

**IMUNOTERAPIA**  
Kjo është metoda e dytë madhore, pas kimioterapisë. Imunoterapia intravezikale me BCG (Bacillus Calmett-Guérin - shkaktari i tuberkulozit) ka treguar se është e para për të reduktuar numrin e përsëritjes së tumoreve Papillare (autor-Morales et al, 1976). BCG ka treguar se është shumë efektive kundër tumoreve tip CIS, duke rezultuar në remission komplet të sëmundjes ekzistuese, deri në 75-80%, të pacientëve të trajtuar me BCG. Bacili i TBC (BCG) si një promotor jo specifik i imunitetit celu-



Mjeku urolog dhe seksolog, prof. dr. Kim Drasa

lar në Urothelium, duke shkaktuar aktivizimin e limfociteve Cytotoxicë dhe lëshimin e Cytokineve, si vrasës tumoral. Toksiciteti është disavantazhi më i madh i BCG, i cili është më i rëndësishëm në rastin e përdorimit të kimioterapisë intravezikale. Permetepër, ky toksicitet mund të jetë substancial në pacientët, të cilët marrin kurse mirëmbajtjeje. Pra, për këtë arsye imunoterapia me BCG përdoret


gjërisht si trajtim i linjës së parë, vetëm në pacientët me rrezik të lartë dhe përdoret si linjë e dytë trajtimi, në rastet me rrezik të ulët por vazhdojnë me recurrence, mbas kimioterapisë adekuate. Disa nga efektet anësore (dëmtimet) nga BCG, mund të parandalohen ose të ulët ashpërsia përmes përdorimit profilaktik ose të Isoniacidit (medikament, i cili përdoret kundër tuberkulozit), mbas secil-

it trajtim intravezikal, por kjo nuk është futur akoma si një trajtim standard. Fatkeqësisht, vdekjet atribuohen direkt vetëm nga BCG. Rreptësisht, BCG duhet të përdoret vetëm nga urologët, të cilët kanë eksperiencë në të dyja së bashku, në administrimin dhe menaxhimin e efekteve anësore nga BCG. Taktika e fundit si shpëtimtare për mospërsëritjen e kancerit të vezikës urinare jomuskul invasive. Kombinimi i injektimit intravezikal të Gemcitabine (GC) me Mitomycin C (MMC) po konsiderohet si fjala e fundit e shkencës për të trajtuar pacientët me kancer të vezikës urinare. Teknika e trajtimit ka 3 etapa: 1) Gemcitabine instalohet (futet nga uretra) brenda vezikës urinare dhe mbahet brenda vezikës për 90 minuta, në një dozë të 1000 mg në 50 ml të ujit sterile. 2) Gemcitabine, pas kësaj, nxirret komplet, me kateter jashtë vezikës urinare. 3) Menjëherë pas kësaj, Mitomycin-C instalohet brenda vezikës urinare, për 90 minuta, në një dozë 40 mg, në 20 ml uji steril. Kjo teknike përsëritet çdo javë, për

6-8 javë. Ky kombinim ideal përdoret edhe te pacientët e rënduar, pa suksese nga mjekimi i mëparshëm si dhe në pacientët, të cilët refuzojnë Cystectomine (heqjen komplet të vezikës urinare).

**KU DUHET TË BËNI KUJDES**

Po patë hematuria pa dhimbje duhet të ekzaminoheni sa më parë, për të hequr dyshimin për tumor të traktit urinar. Të gjitha rastet me tumore, duhet të diskutohen nga një ekip multidisiplinor. Tumoret kanceroze superficiale (pa prekur muskulaturën), me rrezikshmëri të lartë, duhet të diskutohen me specialistët kryesorë të kësaj fushe. Cystectomy (heqja komplet e vezikës urinare) duhet të kryhet vetëm në qendra të specializuara, ku të paktën çdo vit kryhen 50 Cystectomi dhe Radikal-Prostatectomi (heqja komplet e prostatës, bashkë me aksesorët). Pacientët duhet të përfshihen plotësisht në diskutime kur është duke u zgjedhur nga ekipi i specialistëve, me kualitet të lartë, taktika e trajtimit të tyre. Unanimisht, këto rekomandime të bazuara në studime, në eksperiencën dhe observimin personal të pacientëve me kancer të vezikës urinare, pa prekur zonën muskulore (NMIBC) janë në unison me evidencat shkencore të kualitetit të lartë si dhe të opinionit të ekspertëve, të cilët kanë ofruar Guidelinet për menaxhimin e pacientëve të prekur nga ky lloj kanceri. "Kolegë të nderuar urologë, zbatoni këtë kombinim të Gemcitabine & Mitomycin - C. Ky kombinim do të shpëtojë shumë jetë nga ky lloj kanceri agresiv. Pacientët të nderuar, kur diagnostikoheni me kancer të vezikës urinare jo muskul invasive (NMIBC), duhet të insistoni tek grupi specialistëve, i cili po vendos për llojin e trajtimit që ata të përdorin këtë kombinim, sepse për momentin ky është kombinimi më i perfekt për shpëtimin nga ky lloj kanceri, tepër malinj", - thekson Drasa.



**K**olla akute zgjat deri në tri javë, ndërsa ajo kronike shkon deri në tetë javë. Kolla shkaktohet nga sëmundje të ndryshme si ftohja në mushkëri, bronkiti kronik, astma bronkiale ose sëmundjet alergjike.

Çaji me gjethet e gështenjës ka dhënë rezultate të mira për të larguar kollën. Gështenja, një nga drurët më të njohur në Shqipëri, nuk mund të vlerësohet vetëm për frutin e mrekullueshëm e të pasur me vitamina, por pema shquhet edhe për ndihmën jep në mjekësinë popullore. Gjethet e gështenjës luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e shumë sëmundjeve. Gjethet e gështenjës janë të pasura me substanca vepruese saponinë, eskulinë, fraksinë, flavoneve, taninë, të cilat ndikojnë dukshëm në qarkullimin e shpejtë të gjakut. Pirja e tri gotave të çajit të përfutur nga farat ose lulet e gështenjës ndihmojnë në funksionimin sa më të mirë të veshkave. Në këtë mënyrë shmangen edhe sëmundjet e tjera, që mund të shfaqen nga çrregullimet që ndodhin në to. Gjethet e thara e të grimcuara të gështenjës shërbejnë në rritjen e lëngut në stomak, duke bërë të mundur dhe shtimin e oreksit. Rezultate pozitive çaji jep edhe në kurimin e sëmundjeve reumatizmale. Janë pikërisht sëmundjet që zhvillohen në mënyrë të theksuar dhe që kalojnë në fazën kronike e të zgjatur. Përdoret në lehtësimin e dhimbjeve të kyçeve dhe gjunjëve, kur vijnë si pasojë e këtyre sëmundjeve. Gjethet e gështenjës në përbërje të tyre kanë veti irrituese për indet dhe shkaktojnë skuqjen e tyre. Çaji rekomandohet edhe te të gjithë ata që vuajnë nga majasëlli. Kjo sëmundje në të shumtën e rasteve shfaqet te moshat e rritura, veçanërisht te të moshuarit, me zgjerim dhe pezmatim të pjesës së poshtme të zorrës së trashë. Menjëherë pas shfaqjes së kësaj sëmundjeje, këshillohet pirja e çajit, pasi majasëlli mund të shkaktojë ndërlikime të tjera. Çaji i përfutur nga



# Mënyra të thjeshta dhe efikase për të eliminuar kollën

gjethet e gështenjës ka dhënë rezultate shumë të mira edhe në pezmatimet e rrugëve të frymëmarrjes. Sëmundjet e grykës janë të një natyre të menjëhershme e të zgjatura dhe karakterizohen nga acarimi i mbulesës së mukozës.

**BRONKET**  
Sëmundja përhapet gradualisht dhe mund të kapë trakenë e bronkeve. Mund të shoqërohet me ngritje të temperaturës dhe me kollë. Shpesh kolla mund të shoqërohet dhe me gëlbasë. Çaji ka dhënë rezultate pozitive në lehtësimin e kollës. Për largimin e kollës këshillohet të pihet çdo ditë lëngu i gështenjës, i ëmbëlsuar me mjaltë. Kur kolla është e shoqëruar me



sekrecione, gështenja është një bimë me veprim antiseptik, që ndihmon në largimin e saj. Ajo bën të mundur lëngëzimin e saj dhe i sëmurit ndihet i lehtësuar. Kjo kurë shërben edhe për të gjithë ata që vuajnë nga astma. Në rastet e krizave dhe kur të sëmurit i merrret fryma, këshillohet pirja e menjëhershme e çajit të gjetheve të gështenjës. Një rol të rëndësishëm japin gjethet edhe në disa prej sëmundjeve të zemrës, në veçanti të çrregullimit të ritmit dhe për pasojë edhe të pulsit. Çaji ndihmon edhe në rastet kur sëmundja shoqërohet me fryrje të këmbëve dhe barkut, për pasojë të

dobësisht të muskullit të saj. Gjatë shfaqjes së këtyre shenjave këshillohet pirja e çajit deri në shërim të të sëmurit. Rezultatet e mira janë arritur nga përdorimi i çajit edhe në çrregullime të enëve të gjakut, që furnizojnë trurin. Edhe në këtë rast nevojitet pirja e çajit të kësaj bime. Për përgatitjen e çajit nevojiten një deri tri lugë me bimën e grimcuar, të cilat hidhen në një enë ku shtohet një gotë me ujë të valuar. Ena mbulohet me kapak dhe lihet në qetësi për 15 minuta. Më pas, çaji kullohet dhe pihet i ëmbëlsuar sipas dëshirës. Ai këshillohet të pihet 1 deri 2 gota në ditë. Këshillohet të përdoret

nga i sëmurit brenda 48 orëve nga çasti i përgatitjes, përndryshe, duke qenë mjedis i përshatshëm për mikroba, prishet. Duhet të ruhet në enë qelqi dhe jo metalike, sepse mund të bashkëveprojë me metalin, duke liruuar lëndë të dëmshme dhe dëmton shëndetin. Çaji duhet të ruhet në vende të errëta dhe të freskëta. Pjesët që përdoren për kurimin e sëmundjeve janë gjethet e thara të gështenjës. Thara mund të bëhet nën çatitë e banesave dhe në vende me hije për të pasur një veprim të ngadaltë. Koha në të cilën arrihet është tri deri në gjashtë ditë. Më pas gjethet e përfutura rekomandohet të ruhen në vende të ngrohta e pa lagështirë, të mbrojtura nga drita dhe pluhuri. Duhet pasur kujdes që gjethet të ruhen në një kuti.

Nëse veprohet sipas këtyre rregullave, bima mund ta ruajë aftësinë e tyre kuruese deri në 18 muaj nga dita e mbledhjes së tyre.

### ÇAJI I LULËKUQES

Një bimë mjaft frytdhënëse në luftën kundër kollës së shkaktoar nga mushkëritë dhe pezmatimi i bronkeve është edhe lulëkuqja. Nga kjo bimë përdoren vetëm petalet e saj. Çaji i lulëkuqes pihet i ëmbëlsuar me mjaltë, sepse ai jo vetëm i jep ëmbëlsi çajit, por ndihmon edhe në përmirësimin e fytit. Petalet e bimës, pasi janë tharë, hidhen në gjysmë gote me ujë. Lihen për 30 minuta dhe nga lëngu i përfutur pihet 1 e treta e masës. Këto çajra shërbejnë edhe në rastet, kur kolla shoqërohet me gëlbasë, pasi e bëjnë më të lehtë nxjerrjen jashtë të saj përmes kollitjes.

### LULJA E BLIRIT

Një tjetër bimë që përdoret kundër kollës është edhe lulja e blirit. Mjekët këshillojnë të pihet tri deri në katër gota me çaj bliri në ditë nga njerëzit që kanë kollë. Efektet do të jenë të menjëhershme.

### FIERI I GURIT


Një tjetër mënyrë që përdoret nga mjekësia popullore për largimin e kollës është fieri i gurit. Çaji i përfutur nga fieri pihet çdo mëngjes nga një gotë.

### LËNGJET E FRUTAVE

Lëngjet e frutave dhe çajrat e shumëllojshëm me prejardhje bimore japin efekte lehtësuese në rrugët e frymëmarrjes dhe në fyt, duke bërë që kolla të zbutet. Mjekët rekomandojnë pirjen në sasi të mëdha të këtyre lëngjeve, 2 deri në 3 litra në ditë. Gjithashtu, ata këshillojnë që, të sëmurët që kanë kollë, të pinë ujë të ëmbëlsuar me mjaltë. Sipas tyre, kjo është një kurë mjaft e mirë për të larguar kollën.



# Këshilla



## Kura popullore që trajton mëlçinë e prekur nga hepatiti C

Mëlçia është një organ në trupin e njeriut që shumica e njerëzve harrojnë të kujdesen. Nëse vuani nga hepatiti C, është e nevojshme të mbron mëlçinë nga dëmtimet e mëtejshme. Hepatiti C është shkaku kryesor i sëmundjes ekstreme të mëlçisë (cirroza) dhe kancerit të mëlçisë, të cilat të dyja mund të jenë vdekjeprurëse. Ka shumë ushqime që mund të ndihmojnë pastrimin e mëlçisë në mënyrë natyrale, duke stimuluar aftësinë e saj për të pastruar mbeturinat toksike brenda trupit. Duke pasur parasysh madhësinë e epidemisë, çdokush dhe të gjithë mund të jetë në rrezik nga hepatiti C. Në shumë vende, testet e hepatitit janë komplekse dhe mund të jenë të kushtueshme, por udhëzuesi i OSHS-së mbi testimin për hepatitin do t'u japë vendeve këshilla për strategji të thjeshta testimi që do t'i ndihmojnë ata për të mundësuar shërbime testimi për hepatitin. Shumica e njerëzve që kanë nevojë për trajtim nuk e marrin atë. Trajti-

mi i duhur i hepatitit B e C mund të parandalojë zhvillimin e shumicës së komplikacioneve të rrezikshme për jetën prej sëmundjeve kronike të mëlçisë, siç janë cirroza dhe kanceri i mëlçisë. Më poshtë po japim disa nga përbërësit e një kure që do të japë efekte çudibërëse në organizmin tuaj. Këta përbërës janë: lëng limoni, lëng portokalli, mente të freskët, 1 litër ujë si dhe mjaltë organik.

### PËRGATITJA

Vendosni ujin në një tenxhere dhe ngrohni derisa të valojë. Shtoni gjethet e mentes dhe valojeni për 5 minuta të tjera. Hiqeni atë nga zjarri lëreni të ftohet për disa minuta, pastaj shtoni limonin dhe lëngun e portokallit. Trazojeni dhe në fund hidhni mjaltin. Konsumoni këtë përzjerje të ftohtë ose të ngrohtë. Ajo pastron mëlçinë tuaj dhe ndërkohë gjithmonë sigurohuni që të hani ushqime të shëndetshme.



## Përdorni kastravec për të normalizuar tensionin e gjakut

Kastravec është një nga perimet që sjell më shumë freski në gatime, por freskia nuk është e vetmja arsye përse kastravec duhet konsumuar rregullisht. Sipas të dhënave, kastravec përmban fibër, proteinë, kalcium, si dhe vitaminat A, B12, B6, C dhe D. Një nga përfitimet madhore që kastravec ofron për organizmin është stabilizimi i kolesterolit. Për më tepër, kastravec forcon imunitetin dhe ka aftësi të jashtëzakonshme në uljen e tensionit të lartë të gjakut. Përgendrimi i lartë i ujit tek kastravec e bën atë një aleat të dobishëm kundër dehidratimit. Në këtë artikull të "AgroWeb.org" do të mësoni më shumë se çfarë mund të bëjë kastravec për të ulur tensionin e lartë të gjakut.

### STABILIZIMI I TENSIONIT TË GJAKUT

Përmbajtja e vitaminave dhe mineraleve të kastravecit e bën atë tepër të dobishëm për shëndetin, veçanërisht për ata që vuajnë nga tensioni i lartë i gjakut. Konsumi i vazhdueshëm i kastraveciteve çon në mënyrë të pashmangshme në stabilizimin e tensionit të gjakut.

### ULJA E TENSIONIT TË GJAKUT

Njerëzit që vuajnë nga tensioni i gjakut duhet të konsumojnë kastravec rregullisht. Ekspertët rekomandojnë që në momentin që tensioni i gjakut rritet, duhet të konsumoni kastravec për ta ulur atë shpejt dhe për ta stabilizuar.

### MIREMBAJTJA E TENSIONIT TË GJAKUT

Nëse tensioni i gjakut rritet në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur, mund të shkaktojë sëmundje të ndryshme kronike siç janë sëmundjet e zemrës apo ishemia. Për të mirëmbajtur tensionin e gjakut dhe parandaluar ngritjen e tij të shpeshtë, njeriu duhet të konsumojë rregullisht kastravec.

### QETËSIMI I TENSIONIT TË GJAKUT

Konsumi i vazhdueshëm i kastravecit jo vetëm e parandalon ngritjen e tensionit të gjakut, por edhe përsëritjen e këtij problemi. Megjithatë, që të mos mërztieni me shijen e kastravecit, mund ta përfshini atë në receta të ndryshme si sallata, lëngje e të tjera.

### KUNDËR DHIMBJEVE TË KOKËS

Tensioni i lartë i gjakut shoqërohet me dhimbje koke dhe dobësi. Për të shmangur këtë gjendje dhe larguar dhimbjen e kokës, "AgroWeb.org" ju rekomandon të pini lëng kastraveci. Ky lëng është i freskët dhe zgjidhje shumë e mirë dhe e shpejtë kundër dhimbjes së kokës. E mira e kastravecit është që jo vetëm që shmang ngritjen e përsëritur të tensionit të gjakut, por edhe e zgjidh atë si problem.

## ISH-MINISTRI I ARSIMIT

Gjithnjë optimist, para katër vjetësh, më 14 shtator 2014, u nda nga jeta e nga populli që e deshi aq shumë, ky burrë i madh, jo vetëm i Elbasanit, por i gjithë Shqipërisë.

# I thjeshtë si njeri, vigan në mendime e veprime...

Nga Rexhep Hida  
e Nikolla Sudar

Të lësh gjurmë të pashlye shme në kujtesën e popullit, këtë do ta dëshironte cilindo që mendon dhe punon për të dhe për atdheun. I tillë ishte dhe do të mbetet përherë humanisti i shquar, personaliteti i madh i arsimit, i kulturës dhe sportit shqiptar, ministri më i suksesshëm në tërë historinë moderne të Shqipërisë, mendjendriuri Thoma Deliana.

Ndonëse vitet, dekadat kalojnë, figura e këtij njeriu të rrallë shndrit gjithnjë e më fort. Ai sikur me atë dashurinë e tij të pakufishme njerëzore, me atë modestinë e tij unikale, u drejtohet njerëzve me fjalë zemre: "Miq të mi! Asnjëherë mos e harroni detyrën e shenjtë për t'i shërbyer atdheut! Mos e braktisni atë, jepni gjithçka për të, se kështu do të fitoni përjetësinë!". Pikerisht më tepër se kurrë, në këto kohëra të vështira për të ardhmen e vendit, figura e madhe e këtij veprimtari të shquar është shembulli më konkret për cilindo, që e do sadopak vendin e vet.

E kush nuk do të dëshironte të thoshte fjalë zemre për këtë burrë të shquar, që e ngriti aq lart figurën e edukatorit dhe të Shqipërisë dhe që i deshi aq fort? Mjaftojnë disa nga vlerësimet e bashkëkohësve për të kuptuar madhësinë e këtij njeriu.

Në kujtimet e veta, ish-zëvendësi i tij, intelektual i përmendur Musa Kraja, i cili do të shkarkohej nga detyra për "pikëpamje borgjezo-revizioniste", shkruan: "Nga njohja ime e drejtpërdrejtë po nënvizoj disa fusha, në të cilat ka spikatur Thoma Deliana. Së pari, ai luajti rolin e një drejtuesi shumë të suksesshëm në masvizimin e arsimit 7-8 vjeçar. Së dyti, nxitu e punoi në zbatimin e politikës arsimore të kohës për përgatitjen e kuadrit të fushës së arsimit në rrugë normale, përmes shkollave pedagogjike, të kulturës, sporteve, të Universitetit të Tiranës, Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, filialet të tyre etj. Ai u shqua për modestinë karakteristike, për aftësinë e shkëlqyer komunikuese, aftësitë organizative, përkushtimin në punë, zemërgjerësinë dhe njëzëllëkun shembullor".

Drejtuari i arsimit në qarkun e Elbasanit, etnologu, historiani dhe publicisti i mirënjohur Thanas Meksi, thekson: "Kam pasur fatin e madh që gjatë kohës si drejtues i arsimit në Elbasan të kisha epër njeriun e shquar e të paharruar, Thoma Deliana. Vështri është t'i japësh përcaktimin e plotë këtij njeriu të madh, mbase më i suksesshmi në veprimtarinë arsimore e kulturore në të gjithë vendin. Ai ishte një masovik i vërtetë, problemet e dikasterit i shtronte para të gjithë personelit. Me atë modestinë e rrallë, ai

(Kushtuar personalitetit të shquar të arsimit, kulturës dhe sportit shqiptar – të paharruarit Thoma Deliana)



Thoma Deliana

kërkonte dhe dëgjonte me vëmendje mendimet e secilit. Përveç aparatit, ato i bënte të njohura edhe për organet e pushtetit në bazë, me të cilët punonte me përkushtim për zgjidhjen e tyre. Horizonti i gjerë shkencor dhe kulturor e bënin me të vërtetë të veçantë këtë reformator energjik. Në morinë e problemeve që duhej të ndiqte, ai veçonte një specifikë shumë të rëndësishme: cilësinë e mesimdhënies (sidomos në hapat e para të shkollimit, në ciklin e ulët). Ndonëse i ngarkuar me shumë detyra, ai nuk linte rast pa marrë pjesë në çdo përvojtor të "Normales" së Elbasanit. Thoma Deliana do të mbetet embleme e arsimit dhe e kulturës së vendit".

Në librin me kujtime "E bekuara mësuesi" të z. Evanthi Ciko (nëna e mjeshtrit të madh të muzikës Zh. Ciko), për vite me radhë drejtore të Shtëpisë së Fëmijës së Tiranës, në disa episode të tij ndihet konsiderata e lartë për ministrin e Arsimit e të Kulturës, zotin Thoma Deliana. Ai është më preshtent ose më mirë i lexuar ndër rreshta, kur flitet për punën e saj (shpesh e quajtur "nëna e 268 jetimeve").

Shprehës është fakti që ky kapitull hapet me një foto kryesore të ministrin Thoma Deliana në mesin e një grupi fëmijësh të Shtëpisë së Fëmijës. Puna e madhe që bëhej në këtë qendër të rëndësishme edukative të jetimëve nuk mund të realizohej pa mbështetjen e ministrin të kohës. Hapja e fondëve për ristrukturimin mjedisor, trajtimin më i mirë i fëmijëve dhe ekspozimi për herë të parë i prob-

lemeve të tyre "pa luster" ishin frut i koordinimit të ideve të përbashkëta.

Z. Evanthi kujton me nostalgji dhe respekt të veçantë momente të paharruara kur Ministria e Arsimit organizoi një seminar vlerësues për Shtëpinë e Fëmijës të drejtuar prej saj, në kohën e ministrin Deliana dhe dekorimin me titullin "Mësuese e Merituar".

"Familjarisht u tronditëm dhe u pikëlluam thellësisht, - thekson në kujtimet e saj, z. Evanthi, - kur mësuam për dënimin e ministrin Deliana, të cilin i quanim të padrejtë dhe të egër".

Personaliteti i shquar i artit dhe kulturës shqiptare, dirigjenti i mirënjohur brenda dhe jashtë vendit, z. Zhani Ciko, kujtimet e tij për të paharruarin Thoma Deliana i ka përmblodhur në një pasazh shumë të ngrohtë dhe me një titull mjaft kuptimplotë "Njeriu i mirë, i kohës së vështirë". Ardha e një jubileu për çdo njeri është mundësia për të kujtuar protagonistin e asaj ngjarjeje sa personale, aq edhe familjare e shoqërore, si në rastin e përkujtimin të zotit Thoma Deliana. Ai ishte personaliteti i viteve të asaj kohe kur, pavarësisht regjimit, kishte shumë nevojë për ndeshmëri njerëzore, qëndrim parimor brenda limiteve të përcaktuara arretsisht, si dhe për kompetencë profesionale, për kulturë dhe vizion historik. Fundi i viteve '60 më krijoi rastin e njohjes personale me të, në funksion të detyrës sime si udhëheqës artistik i Teatrit të Operas e Baletit dhe Ansambllit të Këngëve e Valleve, ku unë si violinisti koncert-mae-

ster i këtij institucioni qëndror, në moshën 24-vjeçare, u ndodha si pjesë e jashtme e ministrisë, që drejtohej nga shoku Thoma.

I ngrohtë që në takimin e parë, besues në idetë e reja që parashatroja me guximin e një jopartiaku siç isha unë, ai nuk nguronte madje të kujtonte me veneration të dy prindërit e mi dhe sidomos kompozitorin Nikolla Zoraci, dajën tim, të cilin gjithashtu e vlerëson-te shumë. Për t'i analizuar më mirë këto karakteristikë ju përmend ngjarjen e ndodhur pas dënimin të

Thoma Deliana, ky fisnik i rrallë, do ta ndiente thellë dashurinë dhe respektin e dhjetëra e dhjetëra njerëzve nga të gjitha shtresat, të cilët e ndalonin dhe e përfaqonin me dashuri e respekt të thellë.

dramës 'Njollat e murme' (1970), e cila kishte pezulluar gjithë jetën kulturore të vendit, sa që në opera na ngriu premierën e baletit 'Cuca e Maleve', vepër që i dha shkas kritikës arriviste të shpaloste mëllefet e egoizmit të tejskajshëm. Ardha e bëftë e diktatorit dhe e bashkëshortes krijoi tension të lartë tek artistët dhe tek ne drejtuesit. Gjithashtu, edhe shoku Thoma, prezent në lozhën e operas, ndjeu tensionin e një sprove, mbase përfundimtare për karrierën e tij. Suksesit dhe vlerësimi tepër pozitiv çlirroi çdo tension si për ministrin, ashtu edhe për drejtorin e atëherëshëm, Koço Vasili, mbështetës gjithashtu i qëndrimeve jokonformiste. Më tutje mund të rendis rastet të shumta si Koncertin Jubilar 1971, ku unë guxova të fus në program 'Koncertin No 1', të F. Ibrahimit për piano dhe orkestrë (ekzekutuar nga M. Kristidhi) e paraqitjen e Suitës me këngë parizane për kor a capella, nga Tonin Arapi dhe të imponoj një koncept profesional. Në rastin e koncertit sektori i kulturës me aparatçikët e tij ishte plotësisht kundër, por që nuk e tronditën dashamirësinë e ministrin Deliana ndaj 'së resë e profesionalizmit', që në fakt filloi të shpaloste një frymë të re në konceptet e ngurta të aparatit kulturor partiak. Pas 'Festivalit të Dizhonit', me atë suksesin e jashtëzakonshëm ndërkomëtar, që ndodhi bash në ato vite kur ai pati



përkujdesjen institucionale që i takonte, por pa ndërhyrë në vendimet tona artistike, gjë e pazakontë për kohën, ministri Deliana u tregua objektiv në vlerësimin e punës sime dhe të operas, sidomos gjatë analizave të egra, pas Festivalit të 11-të. Thoma Deliana me qëndrimin e tij mbështetës, doli kundër zëvendësimit të tij, njëherësh edhe sekretar i partisë për dikasterin, i cili kishte dalë të krasite çdo lule të brishtë, që nxirrte kryet në ranishen e thatë të izolimit kulturor. Çlirimi nga 'makthi i kohës' na solli mundësinë që t'u rikthehemi eksperiencave dramatike të gjithsecilit, pas viteve '90 dhe ta kujtojmë personalisht zotin Thoma, i cili na telefonoi për të njoftuar kthimin e tij të lirë në Tiranë".

Në përditën kur drejtohte sh. Thoma Deliana, dikasteri mbulonte edhe problemet e sportit. Ja si e përshkruan eporin e vet rekordmen kombëtar në atletikë, mjeshtri i sportit dhe ish-inspektor i sporteve në ministri, Sokol Morina: "Mbase duhet të kalonjë vite që të japësh vlerësimin e duhur për një personalitet në zë. Por, për të madhin Thoma Deliana mjaftonte vetëm një herë ta takojë dhe menjëherë të krijohej përshtypje se kishë njohur një njeri të vërtetë. Gjatë disa viteve pune në dikaster kam pasur rastin të dalloj të veçantë tek ky drejtues i shquar dhe i përkushtuar. Më kujtohet viti 1966. Në Bullgari do të zhvillohej krosi mbarëballkanik. Atletet tona të mirënjohura Adile Dani, Lumturi Markolaj dhe Elisabeta Muca do të konkurronin me më të mirat e Ballkanit, që ishin rekordmen dhe në Evropë. Mbështetja e ministrin Deliana qe e gjithanshme. Para nisjes e takova dhe ai me humor më tha: 'Mos na e bëni si ata që shkojnë për-lesh dhe kthehen të qethur!' Ndërkohë nuk më harrohet çastet kur gati me sytë e përloitur më përqafoi me shumë dashuri e respekt, sepse ekipi ynë zuri vendin e parë. Në një rast tjetër, ishte viti 1973, kur në Institutin e Kulturës Fizike ishin shfaqur probleme serioze. Në ekipin e dërguar bëja pjesë edhe unë. Gjatë konkluzioneve m'u drejtua mua (ai i jepte rëndësi parësore mendimit të specialistëve). Në ju përgjigja: 'Shoku ministër, nga të gjithë sektorët dërgohen specialistë për specializim jashtë vendit, kurse sektori i sporteve punon me arritjet





← e viteve '50'. Ai më dëgjoi me shumë vëmendje dhe nuk vonoi që kolegj tanë dhe studentët të dërguan për specializim në Kinë. Ai ishte njëri i fjalës dhe i punës si rrallëkush".

"Mjeshtri i madh i Punës", dirigjenti i mirënjohur brenda dhe jashtë vendit. Ermir Dizdari, shprehet kështu për eporin e vet: "E konsideroj privilegj që të them disa fjalë zemre për njeriun e shquar, Thoma Deliana. Për të mund të flasësh shumë, por unë do të përmend një ngjarje madhore, e cila la gjurmë jo vetëm në Durrës, por në tërë vendin. Në përkujtim të 500-vjetorit të vdekjes së Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut, më 1968-ën u mor një iniciativë sa e bukur aq edhe e vështirë: vënia në skenë, në Durrës, e operës "Bijtë e Skënderbeut", e kompozitorit Abdulla Grimci, vetëm me amatorë. Vështirësitë ishin të shumta, përvoja na mungonte, por jo entuziazmi. Angazhimi i drejtuesve në rreth që maksimal. Po ai i ministrit të Arsimit dhe Kulturës, z. Th. Deliana që tepër i veçantë. Thjesht për ngritjen e orkestrës filarmike të qytetit, prej 60 instrumentistësh, mungonte gjithçka. Me iniciativën e tij nga rezervat e shtetit u siguruan vegla cilësore, të cilat ishin blerë për Teatrin e Operës. Ai u kujdes që për të ndihmuar në realizimin me sukses të kësaj iniciative të vlinin nga Tirana artistët më të shquar të operës. Vetëm në Tiranë opera "Bijtë e Skënderbeut" u shfaq pesë net me radhë".

"Piktori i Merituar", tashmë me reputacion brenda e jashtë vendit, Agim Faja, për mjaft kohë drejtues i degës së Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve për rrethin e Durrësit, thekson: "Poeti ynë i madh, Lasgush Poradeci thotë: 'Prej çdo gëzimi e hidhërimi/ Mbetet prapa veç kujtimi/ Ah, edhe i shkreti, mallëngjimi!' Kujtoj njohjen tonë të parë me të paharruarin Thoma Deliana në vitin 1967, që më la mbresa të

veçanta. Ai jo vetëm që i donte dhe i respektonte shkrimtarët dhe artistët, por bënte çmos, duke ndërhyrë edhe në instancat më të larta për t'u siguruar tyre gjërat e nevojshme në ecjen përpara të krijimtarisë. Tek ai nuk gjenim strehë egolzmë suksesi e shokëve e të miqve. I tillë që shokut Thoma. Njeri me kuptimin e vërtetë të fjalës, që edhe hallet e të tjerëve i përjetonte si hallet të veta. Më kujtohet kur pata kërkuar fonde për ngritjen e disa studiove për piktorë e skulptorë në Durrës, Kavajë e Shijak. Shoku Thoma mu drejtua: 'Ju vazhdoni punën tuaj dhe ju jap fjalën se, kur t'i përuoni, do të vijë edhe vetë'. Dhe më pas për krijuesit e Shijakut bëme katër studio dhe si gjithnjë e mbajti fjalën. Ai ishte dhe mbeti njeri i thjeshtë, human, me shumë humor, por edhe dituri. Në një bisedë më të ai më foli me shumë ngrohtësi për normalistët elbasanas si Abedin Çausi, Shefqet e Drita Demiri, Gjeovefa Stambolla, Myrteza Vërçani, Sigfrid Deliana, Hasan e Xhyhere Belshaku, Mali e Razije Llanaj, që kishin kontribuar kaq shumë për zhvillimin e arsimit në krahinën e Shijakut. Me respekt fliste edhe për veprimtarët e palodhura të arsimit, shijakasen Mereme Shkodra, që kishte kryer shkollën 'Nana Mbret-neshë', Xheje Arbanën etj..

E kujtofishim gjithmonë me respektin më të madh njeriun e mrekullueshëm, Thoma Deliana".

Cili ishte Thoma Deliana? Çfarë i dha ai popullit dhe atdheut?

Thomai u lind në Elbasan, më 20 shkurt 1924, në një familje të thjeshtë, por me emër në qytet. I pari i tyre, Ndrek Deliana kishte ngritur strehën e vet në lagjen "Kala". Ndreka kishte gjashtë fëmijë e midis tyre do të evidentohet Thomai, njëri nga argjendarrt më në zë të qytetit. Ky kishte djalin Mihalim, i cili rriti dhe edukoi me virtytë të larta Noshin, që më vonë u bë drejtor i Institutit të Kualifikimit të Mësuesve; Afërditën, pedagogë në fakultet dhe veprimtarin e rrallë e me të kaluar të ndritur, ish- ministrin e Arsimit, të dënuar nga diktatura, Thoma Deliana.

Ishin kohëra shumë të vështira për atdheun, kur ai djalosh filloi studimet në Normalen e Elbasanit. Që në atë kohë do të spikatnin dy tipare që do të përbënin më vonë edhe domethënien e karakterit të tij: etja e madhe për dije dhe shpirti altruist.

Fare iri ra në kontakt me të rinj antifashistë si vëllezërit Xhuvani, Petro Kitën, Zihni Muçon, Kostaq Lazrin, Përfesoni Todrin (Derwish), me të cilët u bëme shokë ideali dhe zhvilluan aktivitet të pandërprerë antifashist. Normalja e Elbasanit, kjo qerdhe e kulturës kombëtare shqiptare, do të kthehej edhe në vatrë të luftës antifashiste për të gjithë vendin. Në vitin 1943, Thomain e gjejmë sekretar politik të rinisë dhe anëtar të qarkorit të partisë. Në këtë kohë drejtuese organizative e rinisë së qytetit do të bëhej Virgjinia Bishka, që kishte ndjekur shkollën femërore "Nana Mbret-neshë". Të dy morën në Kongresin e Rinisë, në Helmës të Skraparit dhe u zgjodhën anëtarë të Këshillit të



Përgjithshëm të Rinisë Antifashiste të Shqipërisë. Shokë ideali gjatë luftës, ndërsa pas lirimit, ata do të shndërroheshin edhe në shokë jete.

Menjëherë mbas lirimit, kur ishte vetëm, 21 vjeç, Thoma Deliana caktohet drejtues i partisë për qarkun e Elbasanit. Pa kaluar shumë Nako Spiro e tërheq në Komisionin e Planit të shtetit. Situata e brendshme politike dhe ekonomike ishte shumë e vështirë. Pikërisht ajo e shpuri drejtuesin e këtij dikasteri në vetëvrasje.

Pas vitit 1948, Thomai caktohet me detyrë në Komitetin Qendror në drejtorinë e organizimit. Por detyrat e kohës ai i lidhte ngushtë edhe me përgatitjen e vet teorike. Kështu nga viti 1954 e deri në vitin 1958 e ndeshim student të filozofisë në Moskë, ku shkëlqeu për rezultate shumë të larta. Pas kthimit në atdhe, përsëri caktohet drejtues i partisë në Elbasan, ndërsa në vitin 1961 emërohet zëvendësiministri i parë të Arsimit, kurse që nga viti 1963 e deri në vitin 1976 ai u do kryente detyrën e ministrit të Arsimit, të Kulturës dhe të Sporteve si askush më parë.

Shumë domethënëse është edhe jeta private, familjare dhe shoqërore e këtij njeriu të rrallë. Thoma Deliana dallohej për kujdesin e jashtëzakonshëm për shokët, miqtë, por edhe për të panjohurit në nevojë. Në një rast i mbërritën 80 ankesa nga Vlora për pakënaqësitë e shfaqura në dhënie e të drejtave të studimit. Ky fakt e shqetësoi shumë ministrin, prandaj vajti vetë në Vlorë, mori kontakt me të pakënaqurit dhe ja rezultati: nga 80 ankesat, 50 prej tyre i zgjidhi pozitivisht. Gjatë qëndrimit të tij në postin e ministrit nuk la rreth pa vajtur, jo vetëm për të zgjidhur problemet që shfaqeshin, por edhe për të festuar me bazën ngjarje lokale dhe kombëtare. Kënaqësi të madhe ndiente kur vizitonte familjet e mësuesve të thjeshtë për t'u uruar 7 Marsin, të cilët e prisnin me përziermësi në të madhe. Ai ishte edhe një prind shembullor dhe të fillë do ta mbanin mend djemtë e tij të mrekullueshëm, Maks dhe Artani.

Si i apasionuar pas muzikës, ai arriti të luante bukur në dy vegla muzikore: në mandolinë dhe violinë. Në momente çlodhjeje, ai ndiente kënaqësi të veçantë të luante me shumë pasion në violinë pjesë nga autorë vendas dhe të huaj. Në studion e tij gjeje me dhjetëra pllaka gramafoni me vepra të autorëve të mëdhenj, sidomos me muzikë operistike. Ai ishte njohës i

mirë i disa gjuhëve të huaja: i frëngjishtes, i italishtes, i gjermanishtes e i rusishtes dhe kishte arritur të krijonte një bibliotekë shumë të pasur me vepra të të gjitha gjuhëve, të autorëve shqiptarë e të huaj.

Dashuria dhe respekti për këtë humanist mori përpjesëtimin shqetësues për kuptimin e vendit. Me rastin e 50-vjetorit të lindjes, nga i gjithë vendi erdhën në Tiranë individë dhe kolektiva për ta urrear këtë burrë të shquar. Me këtë rast mbërritën për vizitë krerët e vendit. Njëri nga ata ishte edhe

Thoma Deliana ishte nga ata burra shteti që me kurajë të jashtëzakonshme parashitroi mendimin e lidhjes me Perëndimin mbi bazën e leverdisë reciproke dhe të moscenimit të integritetit.

Hysni Kapo. Kur ministri po e përcillte, byroisti u shtang kur dalloj para derës, të vënë në rresht, njëzë të shumtë. Sekretari i KQ i drejtohet i habitur ministrit: "Ç'janë tërë këta njerëz, o Thoma"? Mikpritësi, i zënë ngushtë iu përgjigj: "Po ja, kanë ardhur të më urrejnë 50-vjetorin!". "Ashtu"? - dhe një hije mllafi mbuloi fytyrën e sekretarit. Por, rrebeshe të kohës do të përplaseshin fort mbi tërë vendin. Prishja e marrëdhënieve me BS dhe vendet e demokracive popullore në vitin 1961 do ta çonte vendin në një izolim të paim-agjinnuar, duke e përkeqësuar gjendjen politike dhe ekonomike të tij si asnjëherë më parë. Por sidomos paranoja e diktatorit Enver Hoxha, e cila në çdo skutë të vendit shihet "armi që partisë e të popullit", do të arrinte apogjeun e vet në vitet '70 të shekullit të kaluar. Goditjet në ushtri, ekonomit dhe kulturë do të sillnin pasoja të shumta negative në të gjitha aspektet e jetës së vendit. Por Thoma Deliana ishte nga ata burra shteti që me kurajë të jashtëzakonshme parashitroi mendimin e lidhjes me Perëndimin mbi

bazën e leverdisë reciproke dhe të moscenimit të integritetit. Gjatë vizitave në Itali dhe Gjermani, ai konstatoi gatishmërinë e singertë të këtyre vendeve për bashkëpunim. Por ku të linte slogani antikombëtar dhe antinjerezor se "do të hamë bar, por nuk do t'ia shtrijmë dorën imperializmit", i cili do të triumfonte në të gjitha sferat e jetës dhe do ta shpinte Shqipërinë në një mjerim të tejshkajshëm. Në këtë vorbull, sidomos nga Plenumi i 4-t, i vitit 1973 e deri në vitin 1976, do të merre goditje pas goditjesh drejtuesi i dikasterit të arsimit dhe kulturës, Thoma Deliana.

Lidhur me këtë fakt, vetë z. Thoma, i tashmë demokrat, do të shprehej: "Më thërrasin në sekretariat-in e Komitetit Qendror të Partisë dhe më bëjnë pyetje: 'Pse nuk flet në plenumet e Komitetit Qendror të Partisë kur diskutohen probleme madhore, kryesisht kur kanë të bëjnë me demaskime të grupeve armiqësore?' Përse je kundër kontrollit punëtor? Etj. Më pas doli një shkrim në gazetën 'Zëri i popullit' me titull 'Një pyetje nga salla' dhe pak mbropa tjetër, një shkrim i dytë me titull 'Frymë erë Elbasani'. Këto shkrime ishin për të goditur direkt personin tim. Kjo nuk ishte e thjeshtë, po të mendoje se shkrime të filloshme nga struktura më të larta të nomenklaturës së partisë. Në shkrimin e parë konkretisht bëhej fjalë për një kontroll punëtor që ishte organizuar në aparat-in e dikasterit tonë për të zhvilluar reformën në administratën e saj. E çuditshme, por propozimi që të shkurtrojnë specialistët, madje me disa tituj shkencorë të dikasterit të arsimit u ishte ngarkuar pikërisht disa kaldaistëve të mblodhur aty këtu. Në një mbledhje që u zhvillua me të gjithë aparat-in e ministrit, ndërsa zëvendësiministri ishte duke folur, atë e ndërpreu njeriu nga ata kaldaistat-kontrollore, i cili, i ulur nga fundi i sallës, ndërhyri: 'Shoku Hasan, duhet ta fillosh diskutimin që nga ministri, nëse duhet të jetë në ministri apo jo'. Ndërsa ai vazhdoi më tej me aludime të ndryshme të kësaj natyre, unë kuptova se tek ai kaldaisti i gjorë që po lozte rolin e kryesorit, po bëhej një lojë e poshtër, me skenar të përgatitur. Po ashtu, edhe shkrimi 'Frymë erë e Elbasani' më kritikonte për faktin që shumë profesorë të universitetit dhe kryesisht në Fakultetin e Shkencave të Natyrës ishin marrë nga Elbasani, i cili i përkiste fëmijëria ime. Harrohej me qëllim këtu fakti se çfarë disertacionesh kishin mbrojtur dhe çfarë titujsh shkencorë mbanin mbi supë këta profesorë. Nuk e vija në dyshim se ishte përgjuar biseda ime e bërë pak kohë më parë me Abdyl Këllezin. Unë në këtë rast nuk e mbajta revoltën e brendshme, por u përgjigja madje me ashpërsi, duke u rreguar rastin e Koçi Xoxës, të cilin e kishin pushkatuar për të njëjtat gjëra se kishte vënë Sigurimin mbi gjithçka. Ishte pikërisht 30 prilli i vitit 1976 kur do t'i jepej mandata e shkarkimit nga detyra dhe e largimit për në Tepelenë, si drejtor shkollë. Ky hap do të pasohej me përjashtimin nga Komiteti Qendror. Kjo që arsyjeja e rëndimit të shëndetit të së

shoqës, Virgjinisë, e cila kaloi në depresion. Fillimisht Thomai u tha se do të drejtohej shkollën e mesme të Tepelenës, por në fakt u caktua si drejtor i shkollës tetëvjeçare të fshatit Dhemblan të këtij rrethi. Por kulmi i denigrimit do të arrihte pas një viti, më 1977, kur përjashtohet edhe nga partia si "armik i popullit". Kalvori i vuajtjeve të rënda fizike do të vazhdohte për vite me radhë në këtë fshat të thellë, kur e detyruan të punonte me kazmë dhe për shumë kohë në punët më të vështira të blegtorisë, vazhdimisht i survejuar nga organet e Sigurimit të Shtetit. Siç vepronjë në atë kohë, pasoja do të kishin të gjithë pjesëtarët e familjes, e shoqja dhe të dy djemtë. Djalin e madh, Maksin, e largojnë në Lezhë, ndërsa djalin e dytë, Artanin, me ndihmën e miqve e me shumë sakrificë kryen studimet e larta. Pas vdekjes së diktatorit, me insistimin e vetë Thomait, në vitin 1986, arrin të kthehet në Elbasan dhe vendoset tek shtëpia e vet e vjetër. Pikërisht në këtë kohë turmat e njerëzve nuk rreshtnin së vizituar këtu njëri të rrallë, sa që u bë problem shumë shqetësues për drejtuesit e kohës në qytet. Vitet e përmbysjes së madhe do ta gjenin në vendlindje, tashmë të rënduar edhe nga mosha edhe shëndeti. Goditje shumë e rëndë për të që ndarja në vitin 1999 nga shoqja e luftës dhe e jetës, veterania e palodhur Virgjinia Deliana. Prej vitesh me banim në Tiranë, Thoma Deliana, ky fisnik i rrallë, do ta ndiente thellë dashurinë dhe respektin e dhjetëra e dhjetëra njerëzve nga të gjitha shtresat, të cilët e ndalonin dhe e përfaqonin me dashuri e respekt të thellë. Tjetër goditje e rëndë për të do të ishte vdekja e parakohshme e të bir-it, kardiologut të mirënjohur Artan Deliana. I rënduar nga vitet, por gjithnjë optimist, para katër vjetësh, më 14 shtator 2014, u nda nga jeta e nga populli që e dëshoi aq shumë, ky burrë i madh, jo vetëm i Elbasanit, por i të gjithë Shqipërisë.

Me shumë modesti dhe tepër i prekur, i biri i të paharruarit Thoma Deliana, profesori i mirënjohur i kimisë, Maksim Deliana, do të shprehej: "Si shumë të tjerë, fati i keq na përfsiu edhe ne. Pasaqat do të ishin të shumanshme dhe negative. Ndonesë kanë kaluar dekada, me respektin më të madh u drejtohem miqve, shokëve dhe njerëzve të thjeshtë që na ndenjin pranë dhe nuk na braktisën, sepse e kuptuan qartë veprimin djallëzor të krerëve të diktaturës. Kudo ku u gjenden prindërit tanë dhe ne, djemtë, diku hapur e diku fshehur e ndjeme thellë dashurinë, respektin dhe gatishmërinë e tyre për të na ndihmuar. Mirënjohja e thellë e familjes Deliana e t'i ndjekë në çdo hap të jetës".

Duke shkruar këto radhë, mendja të shkon tek ato kadro të shquara të asaj kohe, të cilët, ndonëse në kushte shumë të vështira, mbetën të pëpëruar në humanizmin e tyre, duke dhënë gjithçka për popullin dhe atdheun. Na takon të gjithëve t'i kujtojmë vazhdimisht këta njerëz të rrallë, që u bënë emblema e këtij vendit, njëri nga të cilët, Thoma Deliana, ka kaluar në përjetësi.

Tiranë, tetor 2018.

Opinion i Ditës

# 4200 qepenat e fatit

Nga Fatos Çoçoli


(vijon nga faqja 1)

... që marrin qiratë, pse shumica e këtyre pikave ku zhvillohen bastet fizike (me letra ku regjistrohet nga lojtari fituesi i mundshëm) janë mjedise të dhëna me qira. Më datën 1 janar 2019 këto dhjetë mijë familje presin me ankth si do të shkojë punësimi i tyre, pasi ligji do të ndryshojë dhe bastet sportive fizike do të dalin jashtë tij. Një premtim i bërë ësh-të që nëse nisin një aktivitet tjetër, do të taksohen me vetëm 5 për qind nga 15 për qind që është tani tatimi mbi fitimin (Po çfarë të bëjnë? Të shndërrohen në ushqimore, kinkaleri, butikë? Nuk kemi të tilla?)

Megjithatë, ulja trefish e detyrimit ndaj shtetit si zor të shmangë mijëra vetë për të mos përfunduar rrugëve. Sikurse përfunduan shumica e 255 punonjësve të kompanisë celulare "Plus", që një ditë të bukur të këtij viti u zhduk pa lënë gjurmë. Kush duhet të mendojë për këta mijëra vetë? A mund të ketë një ulje të përshkallëzuar të aktivitetit të lojërave të fatit me bastet? Vetë përfaqësuesit e kompanive të basteve (janë tri të tilla kryesore të licencuara tek ne, që kanë hapur këto 4200 pika në të gjithë territorin e vendit) pohojnë se mund të pranojnë të ulin pikat që menaxhojnë në 300 secila (duke kaluar në 1500 pika në të gjithë vendin, pasi ligji lejon regjistrimin e pesë kompanive kryesore). Nëse e pranojnë këtë dhe u ofrohet kjo gjë, ndoshta nuk do të hedhin në gjyq ndërkom-bëtar shtetin tonë.

Nëse më 1 janar 2019 të gjitha bastet fizike mbyllen, sikundër janë shumë gjasa, kompanitë do të rëndin në gjykatat ndërkom-bëtare duke hedhur në gjyq shtetin dhe Buxhetin tonë të Shtetit. Për të mos shkuar në gjyq me CEZ paguam 120 milionë euro, pse nga humbja e gjyqit mund të paguanim edhe dyfishin. Kompanitë e basteve që do të mbyllen në 1 janar 2019 kanë licenca të rregullta nga shteti një për të zhvilluar aktivitet 10-vjeçar, deri në vitin 2026. Ndërprerja e menjëhershme e aktivitetit pa një arsye të paracaktuar në kontratë e bën të cenueshëm shtetin tonë. Deri në nivelin e 180 milionë eurove gjoja, nëse të gjitha kompanitë na hedhin në gjyq dhe e fitojnë gjyqin ndërkom-bëtar (gjë që ka shumë mundësi). A jemi në gjendje në të paguajmë një haraç të tillë?

Humbjen e vendit të punës së mijëra familjeve dhe humbjen rreth 200 milionë eurove të Buxhetit të Shtetit (pa llogaritur të ardhurat e munguara nga taksimi i aktivitetit që çdo vit shkojnë rreth 25 milionë euro)? A nuk mund të ketë një zgjidhje të mesme ku dhe mishi të piqet, edhe helli të mos digjet? Një kufizim i fortë dhe gradual i basteve fizike,



për të shkuar drejt shuarjes së tyre në një hark kohor 2-3 vjet? I dimë të gjithë të këqijat e pasionit të basteve, që mund të shndërrohet lehtë në ves të pakthyesëm. Për shkak të një ligji lojërash fati të masakruar nga ndërhyrjet e politikës në vitin 2015, brenda dy viteve sot kemi një gjendje ku pikat të basteve dhe qendrat e lojërave të fatit janë shtuar tri herë. Duke shkatërruar mijëra ëndrra të pas-tras për sukses në jetë, duke thithur energjinë dhe shpresat jo vetëm të rinjve tanë që mbledhen aty në dhjetëra mijëra, por edhe mesoburra e të moshuar!

Krahas rekordit botëror në numrin e bar-kafeneve, duke ia kaluar edhe Spanjës (654 bar-kafene për 100 mijë banorë), kemi thyer me pasionin-ves të basteve edhe rekordin e pikave të basteve për 100 mijë banorë! Na e kalojnë për num-

rin e lojërave të fatit në një sipërfaqe mbi 1000 ha vetëm Monte Karlo dhe Las Vegas! Në 12 kompanitë më të mëdha private në Shqipëri, që kishin më shumë se 1000 punëtorë, tri ishin kompani të lojërave të fatit në vitin 2017! Bastet po rrezikojnë të kthejnë jo vetëm të rinjtë që i luajnë, por të gjithë ekonominë dhe shoqërinë tonë në parazitare, përtace dhe primitive, ku njerëzit nuk punojnë, por... luajnë. Vënë baste nëpër loto, diskutojnë gjithë ditën për shanset e fitores, mes një gote raki, dy krriklave birë apo 5 qofteve. Në vend që paratë e shqiptarëve të kanalizohen në sektorë prodhues e premtues për shërbimet si turizmi, agro-turizmi, produktet bujqësore për eksport etj., shumica shkojnë në të 4200 pikat e basteve dhe ikin jashtë vendit, pasi vlera e bastit nuk mbetet këtu. Shumë pak mbetet këtu.

Kompanitë tona veprojnë më shumë si seksere, pasi basti përballohet jashtë shtetit. Këto lojëra thithin edhe shpresën e fundit për energji pozitive dhe nisma biznesi, ku protagonistë të jenë të rinjtë. Në të kundërt: këta mësohen të fitojnë para duke... luajtur skedina! E dimë mirë se kjo situatë është prelude i shkallimit të moralit të të bërit shtet, apo të formatimit të një ekonomie të shëndoshë. Por, shëndoshja e ekonomisë dhe shoqërisë duhet të vijë gradualisht. Ajo kurrësi nuk mund të prodhohet nga një akt ekstrem, nga një frenim total dhe mbyllje e 4200 qepenave të fatit. Nëse frenojmë kështu, kostot do të jenë të rënda, në plan social dhe në goditje të fortë të Buxhetit të Shtetit, me pagesa gjobash ndërkom-bëtare në nivele 50-80 milionë euro në vit.

## HOROSKOPI

### DASHI

Marrëdhënies në dashuri kushtojni më shumë vëmendje, për shkak se nuk e keni bërë një gjë të tillë kohëve të fundit. Me familjen do të keni një marrëdhënie harmonike. Një punë që e kishit lënë në mes do të mund ta përfundoni.

### DEMI

Në çështjet e dashurisë do të favorizoheni. Situata juaj ekonomike nuk do të jetë shqetësuese. Ndërsa sa i përket shëndetit, duket se gjithçka po shkon mjaft mirë. Pra, me pak fjalë, ditë me fat për ju.

### BINJAKET

Përpunimi të kujdeseni më shumë për fizikun tuaj. Nuk jeni shumë i favorizuar sa i përket shëndetit, por bëhet fjalë për gjëra të lehta. Edhe nga ana ekonomike sot mund të keni shumë shpenzime.

### GAFORJA

Ndërsa në punë do të keni lajme të mira, nuk mund të themi të njëjtën gjë edhe në dashuri. Kohët e fundit raportet me partnerin mund të ketë pasur probleme që mund të mos kenë ardhur për shkakun tënd.

### LUANI

Ende nuk keni marrë meritë për punën tuaj të jashtëzakonshme. Mos harroni se asgjë nuk do të humbasë dhe sot mund të jetë një ditë ku mund të vlerësoheni në punë. Sa i përket dashurisë, ndjeni nevojën e një personi.

### VIrgjeresha

Nëse po mendoni që të realizoni një udhëtim, sot është ditë e favorizuar në këtë drejtim. Në dashuri keni disa momente jo shumë me fat, por nëse tregoheni këmbëngulës, gjërat do ju ecin mbarë.

### PESHORJA

Ditë e mbarë në çështjet e parave. Nëse keni në plan për të bërë një bërje, mos hezitoni. Sa i përket fushës së ndjenjave, do të arrini të kaloni momente të këndshme me personin që doni.

### AKREPI

Nuk do t'ju mungojë energjia për të çuar përpara planet dhe projektet, por dikush mund t'ju pengojë qëllimisht. Përpunimi t'i kaloni këto pengesa, duke përdorur aftësitë tuaja të lindura. Në dashuri gjërat ju ecin mbarë.

### SHIGJETARI

Tregoni kujdes me shpenzimet. Nuk favorizoheni në lojërat e fatit, ndaj mos harxhoni kohën tuaj të vyer. Investoni më shumë në raportet familjare. Mos lini pas dore detyrat që ju përkasin.

### BRICJAPI

Mos e teproni me pijet alkoolike dhe bëni më shumë kujdes me shëndetin. Situata ekonomike po përmirësohet gradualisht, por nuk është ende koha për të bërë shpenzime të mëdha.

### UJORI

Në çështjet e dashurisë jo çdo gjë po shkon si duhet. Mungesa e vëmendjes ndaj partnerit mund t'ju fusë në labirinte të thella. Kjo nuk është dita ideale për të bërë investime të shkuajdesura.

### PESHQIT

Mund të merrni lajme të mira në punë. Një rritje rroge apo promovim duket në sfond. Në dashuri luani me kujdes, sepse mund të shkatërroni gjithçka. Kaloni më shumë kohë me familjen tuaj.



Opinioni **i** Ditës

# Pse e sharruan sauditët gazetarin Kashoggi në Turqi?

Nga Berat Buzhala

(vijon nga faqja 1)

Turqia e liroi priftin amerikan që po e mbante për dy vjet në paraburgim për shkak të dyshimeve se ai ishte pjesë e "puçit" ushtarak, akt i cili i kishte tendosur raportet e tyre me SHBA-të.

Këtë akt të Turqisë e përshëndeti Donald Trumpi dhe tha se një gjë e tillë do t'i normalizonte marrëdhëniet në mes dy shteteve.

A mund të ndërlihet lirimi i priftit me ngjarjen në konsullatë? Këtë gjë ndoshta nuk do ta dimë kurrë, por është e pabesueshme që këto dy ngjarje të janë koincidence e pastër. Stambolli që prej Luftës së Dytë Botërore, për shkak të pozitës gjeografike, që i lidh dy kontinente, gjithmonë ka qenë fushëbetëje e shërbimeve sekrete. Sigurisht që këto shërbime nuk kanë vendosur t'ia fusin gjumë gjatë këtyre ditëve të fundit.

Në anën tjetër, derisa po ndodhnin këto zhvillime, Arabisë Saudite po i dëshontote forumi ekonomik që ishte planifikuar të quhej "Davosi në Shkretëtirë". Vitin e kaluar Princi Bin Salman kishte paralajmëruar që shumë shpejt do të fillonte ndërtimi i një mega-qteti në mes të shkretëtirës, ku do të fillonin të vlenin rregulla të reja religjioze. Infomatat të këtilla kishin qenë muzikë e mirë për Perëndimin, se më në fund dikush kishte vendosur që t'i hapte dritaret për ta ajrosur këtë vend të mykur nga primitivizmi. Mirëpo, pas incidentit në konsullatë kompanitë më të fuqishme të botës filluan ta paralajmërojnë bojkotimin e samitit. Të njëjtën gjë e bënë edhe shtetet e Bashkimit Evropian. SHBA-të po kërkonin pak më shumë prova që do ta dëshmonin involvimin arab në krimin e kryer në Stamboll.

Presidenti Trump po kalkulohte. Herën e dytë kur doli përpara mediave, pas bisedës që e kishte zhvilluar me Mbretin dhe Princin arab, tha se ekzistonte mundësia që krimi i kryer në konsullatë të ishte realizuar pa djeninë e mbretërisë arabe, kokë në vete nga një elitë vrastare, e dalë jashtë kontrolli. Presidenti Trump, dhe të gjithë ata që po provonin ta zbusnin përgjegjësinë e Princit, po aludonin që truri i operacionit kishte qenë zëvendësuesi i shërbimeve inteligjente saudite Ahmed bin Hassan bin Mohammed Assiri. Kjo zbutje e qëndrimit amerikan u duk sikur po u jepte oksigjenin e duhur sauditëve, që, ndonëse kishin kaluar dy javë nga krimi, edhe më tutje nuk e kishin ndarë mendjen se si ta praninin këtë



vrasje e të mos penalizoheshin nga bota, respektivisht SHBA dhe Bashkimi Evropian.

Donald Trump, në bazë të reagimeve të bëra, dukej i interesuar që situatën ta mbante të tensionuar, ta rriste presionin ndaj Arabisë Saudite, por që çdo gjë të mbetej nën kontroll - nën kontrollin e tij. Pak a shumë Trumpi ishte i interesuar që ai personalisht t'i përcaktojë kushtet e dorëzimit për arabët. Dukej që kur fliste për gazetarin e vrarë ai në mendje e kishte një kontratë të lidhur më herët me Arabinë Saudite, në vlerë prej mbi 100 miliardë dollarë. A kishin filluar amerikanët ta shfrytëzonin mundësinë e artë për t'u vënë kushte arabëve që të fillonin të paguanin shumën e kontraktuar, në këmbim të mbështetjes së tyre në këtë kohë kaq të rëndësishme për ta? Këtë marrëveshje kaq të madhe financiare, e cila premtonte 600.000 vende të reja të punës, Trumpi e kishte propaganduar aq shumë në opininë, mirëpo MBS edhe më tutje nuk e kishte vënë dorën në kushtet.

Ky dukej një moment ideal për Presidentin Trump, i cili gjithashtu, sikurse edhe Erdogani, nuk ka qenë kurrë ndonjë mik i madh i gazetarëve, por as i të drejtave të njeriut. Prandaj kishin të mundësi që kriza e re në Lindje të Mesme të ishte një mundësi më shumë për të që të impononte kërkesat e tij. Pa ndonjë transparencë të madhe ai e nisi për në Arabi Saudite dhe Turqi sekre-

tarin e shtetit, Mike Pompeo, për të mësuar më shumë rreth kësaj ngjarjeje, e sigurisht për t'i bërë të ditura sy më sy edhe kërkesat e Amerikës. Arabët ndërkohë po luajn shumë ashpër. Po e mohojnë që e kishin vrarë gazetarin dhe gjithashtu po thoshin se kushdo që do të guxonte t'i penalizonte me sanksione, ata do t'i përgjigjeshin me të njëjtin mënyrë.

Arabia Saudite, dhe satelitët e saj në rajon, duke qenë prodhuesi kryesor i naftës në botë, vazhdimisht vetëmbrohet duke kërcënuar me ndalje të prodhimit të naftës, duke shkaktuar ngritje çmimesh kudo. Ngritja e përnjëhershme e çmimeve të naftës do ta dridhte ekonominë botërore. Përveç kësaj, Arabia Saudite një letër tjetër të fortë në dorën e saj e ka edhe mbajtjen nën kontroll të Iranit, kundër të cilit SHBA-të po planifikojnë sanksione të reja. Një gjë e tillë është e pamundur, pa mbështetjen e sauditëve. Por, në anën tjetër, as sauditët nuk janë në pozitë për t'u shpëputur nga influenca amerikane. E gjithë forca e tyre ushtarake është e mbështetur në blerjet nga SHBA dhe BE, e posaçërisht nga të parët. Ata edhe po të donin nuk do të mundnin që të krijonin një aleancë të re politike dhe ushtarake kaq shpejt e shpejt.

Për të gjitha këto arsye, shumëkush ishte i bindur që gjatë ekspeditës së Pompeo në Riad dhe Ankara, vrasja e gazetarit, ose enigma e vrasjes së tij, do të mund

të ishte vetëm njëra nga temat, por assesi më e rëndësishmja. Pak a shumë sikurse vrasja e Princit Ferdinand në Sarajevë. Kur Gavrillo Principi kishte shtënë në princin austriak askush nuk kishte thënë "o burra filloi Lufta e Parë Botërore". Ajo vrasje vetëm e kishte hapur lojën. Në fundin e Luftës së Parë Botërore të gjithë e kishin harruar princin e gjorë. Lufta ishte bërë për territore dhe për aleanca.

Mirëpo është herët ndoshta që të kalkulojmë në përmasa të tilla. Ajo çfarë dihet është se Pompeo nuk kishte kaluar kushti si mirë në Arabi Saudite. Këtë gjë e reflektoi Trumpi kur filloi ta sforconte gjuhën duke deklaruar se "hakmarrja do të jetë e ashpër nëse vërtetohet që Arabia Saudite qëndron pas vrasjes". Trajektoria e deklaratave të Presidentit Amerikan gjatë gjithë kësaj kohe ka ndryshuar. Çdo bisedë telefonike e tij ose e bashkëpunëtorëve, çdo takim sy me sy, ka krijuar situata të reja retorike.

Ndërkohë Arabia Saudite i kishte dhënë leje Turqisë që të futet në konsullatë, por edhe në objektet e tjera të personelit saudit, që të kryente hetimet e duhura, për të mësuar se çfarë kishte ndodhur. Një gjë e tillë po e prisnin të gjithë, në mënyrë që ta jepnin verdiktin final. Derisa turqit ishin futur në objektet diplomatike, mediat Perëndimore po raportonin se Princi MBS ishte afër që ta pranonte përgjegjësinë e vrasjes së gazetarit Kashoggi,

por që për një gjë të tillë ai do t'i fajësonte të tjerët. Hetuesit turq, në anën tjetër, po raportonin se si në segmente të caktuara të Konsullatës së Arabisë Saudite ngjyra e murit ishte e freskët, që dëshmonte se personeli aty ishte preokupuar për t'i fshehur gjurmët e gjakut.

"Ne po kërkojmë fakte për krimin, mirëpo ne po e shohim që fakti kryesor është ky, dikush e ka ngjyrosur konsullatën për t'i fshehur krimet. Çfarë faktesh të tjera po kërkojmë?", e shtronin pyetjen gazetarët e mediave amerikane, një numër i të cilëve kishin punuar me gazetarin e vrarë.

"Asnjë krim nuk është perfekt. Nuk do të mund të fshihej gjurmët e gjakut. Sot teknologjia ka përparuar mjaftueshëm sa për ta zmadhuar 1000 herë më shumë një njollë të vogël të gjakut, e cila mund të jetë fshehur diku në ndonjë skutë të konsullatës", tregonte në CNN një ekspert e fushës mjeko-ligjore. Spekulohet se sauditët tashmë nuk kishin ku të fshihehin më, përveçse ta praninin krimin. Pyetje që shtrrohet ishte se në çfarë forme do ta bënin këtë? A do të mbahej përgjegjësi MBS për këtë krim, dhe i njëjti të largohej nga detyra që e mbante, si zëvendëskryeministër dhe si trashëgimtar i fronit mbretëror? Nëse ky jo, atëherë cilat koka do të bënin dhe a do ta pranonte Perëndimi, pas kësaj ngjarjeje MBS-në si interlokutor?

Kur po bëheshin këto pyetje, në ditën e 17-të të zhdukjes së gazetarit Jamal Kashoggi, Arabia Saudite për herë të parë e pranoi se i njëjti ishte vrarë në selinë e tyre në Stamboll. Sipas versionit zyrtar, vrasja kishte ndodhur kur hetuesit sauditë kishin provuar që të bisedonin shtruar me Kashoggin, brenda në Konsullatë. Ndërkohë kur ata kishin filluar të bisedonin me të, vazhdon për ralla saudite, kishte shpërthyer një përlëshje me grushte në mes të Kashoggit dhe 18 sauditëve dhe në përlëshje e sipër Kashoggi kishte humbur jetën.

"Mirëpo, nëse kjo është e vërtetë, atëherë për çfarë arsye njëri prej 18 agjentëve specialë sauditë e kishte me vete një sharrë për prerje të kokave", pyet në editorialin e vet gazeta "The New York Times".

Sauditët, në rëfimin e tyre zyrtar, thanë se kur e kishin parë që Kashoggi kishte vdekur atëherë një staf lokal në konsullatë e kishte marrë trupin e tij dhe e kishte hedhur diku në pyjet rreth Stambollit.

Askush, përveç Presidentit Trump, nuk e mori seriozisht këtë rëfim imagjinar të sauditëve. Kjo marrje e përgjegjësisë prej anës së tyre erdhi vetëm disa ditë pasi që në Bloomberg, Mohammad bin Salman kishte thënë se Jamal Kashoggi kishte dalë i gjallë nga konsullata. Brenda kësaj fjalie vetëm gjysma është e vërtetë: Jamal Kashoggi kishte dalë nga konsullata.

Mediat Perëndimore, të cilat deri dje i referoheshin me një simpatizant princit saudit si MBS, akronimi i shkronjave të para të emrit dhe mbiemrit, tash kanë ndërruar mendje, ani pse po vazhdojnë ta përdorin të njëjtin akronim, mirëpo për arsye tjera: Mr. Bone Saw, ose Zotëri Sharra e Kockave.

"Është e mundshme të ketë ndodhur kështu", tha Trumpi, duke shtuar se do ta vazhdojë planin për tregti me princin saudit.

**DERBI I MILANOS**

Mauro Ikardi ishte heroi i Interit në derbin e Milanos, pasi një gol i tij në kohën shtesë i dhuroi fitoren zikaltrëve, në një ndeshje që deri në momentin e golit nuk dhuroi shumë emocione. Në pjesën e parë Interi ishte dominues, por nuk arriti të gjente golin. Pas vetëm 13 minutash lojë, Interit i anulohet një gol



për një pozicion jashtë lojë të Ikardit, i cili befasohej nga vendimi i gjyqtarit. Zikaltrit përpiqen që të shtyjnë përpara dhe rrezikojnë sërish me Ivan Perisic, i cili përpiqet të devijojë në kuadrat një krosim në zonë, por Donarumma largon topin në goditje këndi. Në të 30', Interi humbet Radja Naingolan, i cili u dëmtua pas një përplasjeje me Lucas Biglia. Belgu rrezikon seriozisht praninë në fushë kundër

**Ikardi shënon në 'frymën' e fundit, Interi mposht Milanin**

Barcelonës të mërkurën në "Camp Nou", pasi ka ndrydhur kavigjelen. Veçino shpërdoron një mundësi të mirë në të 34', kur edhe pse brenda zonës, e dërgon topin mbi traversë, ndërsa Ikardi bën të njëjtën gjë, por me kokë 7 minuta më vonë. Tri minuta para fundit të pjesës së parë

është Milani, që shënon me anë të Musakios, por goli me kokë i argentinasi gjithashtu anulohet për pozicion jashtë lojë. Në pjesën e dytë Handanovic dhe Donaruma ishin më tepër spektatorë, pasi sulmet respektive treguan mungesë të theksuar idesh. Por në minutën

e 92-të ishte Ikardi që siguroi trepikëshin për zikaltrit, kur pas një krosimi në zonë të Vecinos kërcëu mbi mbrojtësit kundërshtarë dhe goditi saktë me kokë falë edhe një daljeje amatore të Donarumas nga kuadrati. Një fitore që e ngjiti Interin në vend të tretë mbi Lacion, 2 pikë pas Napolit dhe 6 pas Juventusit. Ndërsa Milani mbetet në gjysmën e dytë të klasifikimit.

Trajneri shkodran vlerëson lojërat e mira dhe beson se pikët do të vijnë shumë shpejt



Jeton Selimi

**Cungu: Kukësi nuk ka asgjë më pak se rivalët**

*Stadiumi, problemi më i madh për verilindorët*

Goditje dhe kundër goditje. Partizani dhe Skënderbeu luajnë si macja me miun mes tyre në vigjilje të përballjes direkte, e cila do të përcaktojë shumë sa i takon krenat të renditjes, me të kuqtë që mund të ngjiten në +5 nga korçarët, të cilat nga ana e tyre do të ngjiteshin një pikë sipër kryeqytetasve në rast sukses. Momentalisht kryeson Partizani me 22 pikë pas suksesit ndaj Luftëtarit dje me rezultatin 2-1, ndërsa kampionët në fuqi janë të dytët me 20 pikë pas triumfit 2-0 ndaj Kamzës.

**PARTIZANI-LUFTËTARI 2-0**

Të kuqtë kërkojnë fitoren e pestë radhazi dhe e gjënë, ndonëse me vështirësi. Luftëtarit pavarësisht problemeve, paraqitet mirë në "Selman Stërmasi", madje arrin të barazojë përkohësisht rezultatin. Partizani kalon i pari në avantazh, kur Mensah shfrytëzon një moment pasigurie në zonën e Luftëtarit dhe shtyn në rrjetë golin e rezultati 1-0. Partizani luan më mirë, por gjirokastritë do të dinë të



shfrytëzojnë maksimalisht pasigurinë e Ibrahimit, duke rikthyer baraspeshën me golin e Vasil Shkurtajt.

Pjesa e parë do të mbyllet 1-1, ndërsa në të dytën Partizani kërkon golin e fitores, por do të vuajë

shumë deri kur Mala pengohet në zonë dhe për kryesorin Cjapi kemi të bëjmë me 11-metërsh, të cilin e

SUPERLIGA		
JAVA E 9-të		
<b>TË SHITUNEN</b>		
Kastrioti - Kukësi	1-2	
Laçi - Teuta	0-3	
<b>TË DIELEN</b>		
Skënderbeu - Kamza	2-0	
Partizani - Luftëtar	1-2	
<b>TË HENEN</b>		
Flamurtari - Tirana	18:00	
<b>RENDITJA</b>		
SKUADRA	N	F
Partizani	9	22
Skënderbeu	9	20
Laçi	9	16
Kukësi	9	16
Teuta	9	14
Flamurtari	8	11
Tirana	8	8
Kamza	9	7
Luftëtar	9	6
Kastrioti	9	4

qetë në përballjen e fundjavës ndaj Skënderbeut. Skënderbeu-Kamza 2-0 Te Skënderbeu nuk ka shumë kohë për të festuar fitoren ndaj Kamzës, pasi fundjava ka impenjimin maksimal për ta. Gjithsesi, ndaj bluve çdo gjë shkon më së miri. Kampionët shënojnë të parët me Oto Xhon dhe më pas kalojnë dritërima kur Plaku bëhet gati të ekezkutojë 11-metërshin që mund të kishte sjellë barazimin, por ish-sulmuesi i Skënderbeut gjuan jashtë mbi tra. Në pjesën e dytë është portieri Aldo Teqja, ai që bën heroin me disa pritje shumë të mira, pritje që ruajnë portën e Skënderbeut të paprekur, por i japin mundësi Dejvi Bregut të shënojë golin e dytë, një gol i shkëlqyer nga goditja e dënimit. 2-0, Partizani është i paralajmëruar.

**TRAJNERI I PARTIZANIT**

**Gega: Jam shumë i kënaqur me trepikëshin**

Trajneri i Partizanit, Skënder Gega tha pas ndeshjes kundër Luftëtarit se i pëlqeu paraqitja dhe reagimi i skuadrës së tij pas golit të pësuar, si dhe pranoi se ka ende shumë punë për të bërë. Për "Supersport", Gega u shpreh: "Personalisht kam pasur raste që them edhe me Kastriotin kishim vështirësi, ndaj Partizanit vijnë me motivim më të madh, është kryeqytet, ekipet e rretheve vijnë e shfaqin gjithçka. Jam i kënaqur nga trepikësi, kishte gabime brenda lojës. Nuk doja të shihja asnjë kokuur, se në futboll gjithçka



mund të ndodhë. U fola djemve që jemi 1-1, siç e filuam 0-0. Nuk duhej të ndjehemi të fyer që pësua gol, se nuk jemi të pathyeshëm, e rëndësishme ishte të

ngremë moralin e të luajmë në bllok, më me agresivitet. Jam jashtëzakonisht i kënaqur se na shpërblyen mundin. Penallti si e jona ka ndodhur flagrante në Laç, mbrojtësi i Luftëtarit ndërhyri ndaj lojtarit tonë. Unë nuk bërtas për kundërshtarin, por më shqetësoi mbrojtësi i djathtë i Luftëtarit, shumë i ashpër e agresiv, mund të dëmtonte Trashin në dy raste. Bisedova me gjyqtarin e katërt, pas të verdhit pashtë tendencën, nuk pashtë qëllim për të parë të verdhin e dytë. Por askush nuk është absolut.

**TRAJNERI I SKËNDERBEUT**

**Shehi: Kamza nuk e meritonte humbjen**

Trajneri i Skënderbeut, Orges Shehi foli për mikrofonin e "Supersport" pas ndeshjes, ku u shpreh i kënaqur me fitoren, por jo me lojën. Sipas Shehit, kjo ishte një nga ndeshjet më të dobëta të Skënderbeut. "Fitorja të ngroh. S'kemi qenë aty ku duhet. Kamza mund të meritonte edhe më shumë. Është një nga ndeshjet më të dobëta. I tillë është futbollit, duhet të mësohemi edhe të vuajmë. Na kënaqin 3 pikët. Në pjesën e dytë jemi tërhequr më shumë seç duhet. I kemi kërkuar të mos tërhiqen aq shumë. Ata janë të rinj




dhe hyn presioni. Meritë e Kamzës që na vuiri në vështirësi. Ndikoi edhe kondicioni jo i duhur i disa lojtarëve. Deme u kthye të enjten nga angazhimi me Kombëtarën. Dalja e Muzakës na kushtëzoi. Radas ka pasur dëmtim. Zëvendësimin nuk mund ta

bënim më shpejt. Opinioni im ka qenë maksimal. Jo më kot thosha që porta do t'i besohet Teqjes. Sot ishte njëri i ndeshjes. I di vlerat që ka ai. S'duhet të kënaqet me pak. Oreskin duhet ta ketë më të madh për të bërë hapa të mëdha".



**Fjalëkryqi (1)**



- 37. Fillojnë detyrën.
- 38. Bektashi këngëtare.
- 39. Andrea aktore.
- 41. Sampras i tenisit.
- 43. Shkroi Korbi (Indic).
- 44. Triolet e Trëndafilës me kredi.
- 46. Kilmer aktor.
- 47. Në krye të robotëve.
- 49. Unë dhe ti.
- 50. Një mund të jetë fetar.
- 51. Stephane poet francez

- VERTIKAL**
- 1. Fillojnë praktikën.
  - 2. Britma e Arkimedit.
  - 3. Ekstreme në trap.
  - 4. Në fund të fundit.
  - 5. Janë fjetoret e ushtarëve
  - 6. Parker regjisor.
  - 7. Vivaldi kompozitor.
  - 8. Një shkop për karambol.
  - 9. Janë firmat rentiere.
  - 10. Një i fundit mbi të gjithë
  - 11. Kufizojnë tatimet
  - 13. Janë nomadë.
  - 15. Panik pa kufij.
  - 16. Fryn detin
  - 17. Sidney regjisor i Serpico.
  - 18. Jep alarmin.
  - 20. Fillojnë nazet.
  - 24. Janë llogari.
  - 25. Alan regjisor.
  - 29. Roman regjisor.
  - 32. Eshhtë X ajo e sulmit.
  - 33. Kapen të parat.
  - 35. Një provë... inteligjence.
  - 37. Një markë lap top.
  - 40. Fillojnë matjet.
  - 41. Rruga e Ferenc Molnar.
  - 42. Qerre pa qe.
  - 45. Fillojnë lirinë.
  - 46. Fillojnë vallen.
  - 48. Në mes të dhomës.


- HORIZONTAL**
- 1. Riza aktor.
  - 7. Një fjalë si hijç.
  - 11. Një mund të jetë diplomatik.
  - 12. Premton të bëhet as.
  - 14. Janë felinë... të zinj.
  - 16. Ami i Maupassant.
  - 18. Heroi i Emilio Salgarit.
  - 19. Qe anarkist i famshëm rus
  - 21. Një mungesë gjaku.
  - 22. Susana shkrimtare
  - 23. Të parat në cilësi.
  - 25. Mbyllin një shtëpi.
  - 26. Mbeten në fund.
  - 27. Qendër në kaos.
  - 28. Ka bërë piktoreskë një i tillë
  - 30. Inicialet e Camus.
  - 31. Motra... e Kolë Idromenos
  - 33. Një konfuzion total.
  - 34. Rastet pa set.
  - 36. Rastisin në krye.

**Fjalëkryqi (2)**

- HORIZONTAL**
- 1. Një doktor... i Fritz Lang
  - 2. U paraprinë hoteleve.
  - 11. Kush nuk ka... nuk ha
  - 13. Eshhtë djall
  - 14. Një mund të ketë i rrallë.
  - 15. Ishin perëndi të Samotrakias.
  - 17. Institucione Botuese Autonome.
  - 18. Eshhtë infeksion në bark
  - 20. Fundi i një samurai.
  - 21. Një markë kafeje.
  - 22. Mbyllin një hark.
  - 23. Mund të jetë emërore.
  - 25. Ishite muzikanti që nuk përsiste.
  - 28. Në krye të avokatëve.
  - 29. Qerre pa qe.
  - 30. Një pjesë e adoleshentëve.
  - 32. Një banor imagjinar i planetit të kuq.
  - 35. Nuk shuhej dot nga Tantalit.

- 36. Desnuda e Goya-s.
- 37. Ruhet ajo sportive.
- 39. Vetëvrasja e samurait.
- 41. Drita pa kufizj.
- 43. Eshhtë yll i skuadrës.
- 44. I dashuri i Aidas.
- 46. Eshhtë zhurmë
- 47. Ishite lulja e harresës.

- VERTIKAL**
- 1. James, armiku i Sherlock Holmes.
  - 2. Eshhtë edhe ajo saudite.
  - 3. Imami aktore
  - 4. I kanë çift turket.
  - 5. Inicialet e Seagal aktor.
  - 6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
  - 7. Në fund të lutjes.
  - 8. Eshhtë sporti me stil të lirë.
  - 9. Mbeten në fund.
  - 10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
  - 12. Conan ai i Schwarzenegger.
  - 13. Gjysmë ditari.
  - 15. Mario, që qe bomber argjentinas.
  - 16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
  - 18. Në hyrje të pistës.
  - 19. Një numër... femrash.
  - 21. Eshhtë qyteti i Besës
  - 24. Qyteti që quhej edhe Sebaste.
  - 26. Njëllj për latinët.
  - 27. Mund të bëjnë stil të lirë.
  - 31. Damon aktor.
  - 33. Eshhtë pije e jona.
  - 34. Në krye të noterëve.
  - 36. Film i Robert Altman.
  - 38. Skuadra merengue.
  - 39. Një pjesë e hasmërisë.
  - 40. Rrallë eshtë përgjysmë.
  - 42. Nisur pa kufij.
  - 45. Fillojnë mobilizimin.



**Gjeni ndryshimin**

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

1	8		9	5	3	6			
						4	5		
	5		2	6				8	
7			3		9	6			4
4				2		5	1		
5		2							
	1	4		8					
	3			6	7				
2			1	3		9			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

5	6	7	9	8	1	4	2	3	
8	9	3	6	2	4	7	5	1	
1	2	4	3	5	7	6	8	9	
4	3	9	8	6	5	1	7	2	
2	5	6	1	7	3	8	9	4	
7	8	1	2	4	9	3	6	5	
6	1	5	7	3	2	9	4	8	
9	7	2	4	1	8	5	3	6	
3	4	8	5	9	6	2	1	7	

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

T	O	K	A	T	L	U	F	R	A	N	Z	
A	R	E	S	F	I	M	A	R	A			
L	I	N	V	E	N	T	I	L	A	T	O	R
L	E	P	E	R	D	I	T	S	H	M	E	
J	A	T	E	R	R	O	R	I	S	T	E	T
A	S	A	M	A	R	A	R	A	R	S		
H	L	O	R	E	N	M	A	R	A	T		
H	A	M	E	S	T	P	A	R	E	T	I	
U	R	T	I	H	S	U	R	A	T	N		
T	I	R	O	I	D	E	T	I	T	V	O	
I	F	E	N	T	E	A	K	A	S	A	R	
M	M	E	N	T	E	S	H	T	A	T	E	
M	A	H	L	E	R	K	R	N	O	T	A	
I	N	E	S	A	K	O	D	T	E	N		
S	T	R	S	E	N	D	E	R	E	T	I	
T	E	A	P	E	N	D	I	M	I	S	A	I
E	N	M	E	N	D	I	M	I	S	A	I	
R	A	A	G	E	T	E	V	E	L	O		
I	T	R	L	Z	A	N	A	K	I	N		
O	Z	A	K	A	T	S	A	R	N	A		
Z	A	B	E	L	M	I	M	E	D			
E	M	E	G	A	T	O	N	T	O	R		
T	O	K	A	A	L	N	D	E	R	A		
P	A	L	A	D	I	N	E	S	T	O	P	

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Argëtim filozofik*

- Disa defekte janë të domosdoshme për hir të individualitetit.
- Karakteri formohet nëpër shtrëngatat e botës.
- Karakter, në gjërat e vogla apo të mëdha, do të thotë të marrësh përsipër ato gjëra që ti ndjehesh i zoti t'i bësh.
- Mirëkuptimi është gjënia e njerëzimit.
- Korrektësia luan shumë rol, por guximi më tepër.

**KRIPTOSKEME**

*Përgjigja e numrit të djeshëm*

K	O	D	I	A	D	P	A	L				
A	R	E	S	T	I	S	M	L	A			
N	A	D	H	E	R	E	T	I	K	E	T	
I	R	M	O	N	I	T	O	R	I			
B	K	A	P	I	T	A	L	I	S	T	E	
A	L	A	P	S	A	T	A	A	T			
L	E	A	E	T	L	M	T	I				
I	S	R	E	I	N	E	T	I	M			
P	I	S	S	O	D	A	M	O				
S	E	K	R	E	T	L	G	O	L			
A	L	E	L	O	N	D	R	A	R	O		
T	E	T	A	B	D	E	R	A	E	G		

- Mos lu nënshiro shumë ndjenjave. Një zemër tepër e ndjeshme është një pasuri e palumtur në këtë tokë të lëkundur.
- Dyshimi rritet sa më shumë që të dimë.
- Mos ëndërrro ëndrra të vogla, sepse ato nuk kanë fuqi t'i vënë në lëvizje zemrat e njerëzve.
- Një përgjigje korrekte është si një puthje e ëmbël.
- Fati na i plotëson dëshirat, por në mënyrën e tij, me qëllim që të na japë diçka përtej dëshirave tona.
- Përçka dhe sundo, bërtasin politikanët; bashko dhe prij është kryefjala e mençurisë.

*Thënie të mençura*

